

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



MËSIME NGA SURJA
“JÂ SÎN”

Tiranë, 2024

Titulli: **Mësime nga surja “Jâ Sîn”**

Përgatiti: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrekttoi: **MA. Isra MERJA**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

FJALA E BOTUESIT

Si ta bëjmë Kur'anin shoqërues në jetën tonë?

بسم الله الرحمن الرحيم

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!

Allahu i Madhëruar thotë: **"...Juve ju erdhi prej Allahut dritë (Profeti) dhe Libër i qartë (Kur'ani)".¹**

Kur'ani është dritë që shkatërron dhe zhduk errësirat që mbulojnë zemrën. Ai ndriçon ndjenjat dhe hap horizontet e të menduarit. Kur'ani rrethon shpirtin, duke e rifreskuar dhe duke e ringjallur atë. Ai na zbulon rrugët e lëvizjeve tona.

¹Sure "El Maide", ajeti 15.

Sa të bekuar jemi ne, myslimanët! Krijuesi ynë, Allahu i Plotfuqishëm, Drita e qiejve dhe e tokës, na ka bekuar me drita të pashuara, na ka bekuar me Kur'anin e shenjtë dhe me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Këtu shtrojmë një pyetje të rëndësishme: Si mund ta bëjmë Kur'anin të ecë në jetën tonë, siç ecën uji në lumenj apo siç ecën gjaku nëpër damarë, apo siç ecën dielli dhe hëna, nata dhe dita? Si mund të sillemi ne me Kur'anin, në këto kohë që jemi sot? A mund ta bëjmë Kur'anin magnetin e jetës sonë, që forca tërheqëse e tij të na mbajë të lidhur gjithmonë, që ajetet e Kur'anit të na tërheqin njësoj siç na tërheq një tablo e bukur dhe ne e shikojmë me shumë vëmendje? Ka mundësi që shoqërimi me Kur'anin është i gjatë, por përqendrimi në të nuk ka ndodhur. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur'ani nuk lexohet me nxitim, por lexohet ngadalë. Kur të arrish te ajeti që flet për Xhenetin, qëndro dhe lute Allahun të të fusë në të. Kur të arrish në një ajet që përmendet zjarri, lutu Allahut që të mbrojë prej zjarrit”.

Këtë metodë të leximit që përmend Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), mund ta zgjerojmë, si vijon:

Kur të arrish në një ajet që përmendet kërkimi i faljes, lutu Allahut, që të t'i falë mëkatet dhe gjynahet.

Kur të arrish në një ajet që përmendet mëshira, kërkoji mëshirë Allahut, sepse Ai është i Gjithëmëshirshmi dhe Mëshirëploti.

Kur të arrish në një ajet që flet për të shkuarit dhe se çfarë u ndodhi atyre, mendo sikur të ishe njëri prej tyre.

Kur të arrish në një ajet që flet për falënderimin, atëherë kujto mirësitë që Allahu të ka dhënë dhe falënderoje Atë për ato dhe lutu Atij që të të mirësojë gjithmonë.

Kur të arrish në një ajet që flet për pendimin, pendohu tek Allahu me pendim të sinqertë e të pakthyeshëm.

Kur të arrish te një ajet që të fton në punë të mira, thuaj: 'I përgjigjem thirrjes Tënde, o Allah'. Premto dhe zbato.

Kur të arrish në një ajet që është lutje, lutu me atë lutje si kërkues.

Këshillat për leximin e Kur'anit, nuk kanë fund, po për arsye vendi e kohe, po e lëmë me kaq. Nëse do të përfitosh sa më shumë prej ajeteve të Kur'anit, atëherë mendo thellë në përmbajtjen e tyre. S'ka dyshim, se i gjithë Kur'ani na jep çelësat e veprave, na tregon, na udhëzon. Kur'ani është libri i vërtetë dhe i të vërtetave.

Që në kohën e krijimit, në këtë tokë, njeriu kërkon të vërtetën. E vërteta më e madhe ka qenë, është dhe do të mbetet Kur'ani i shenjtë, për të cilin Allahu i Madhëruar thotë: **"Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtra nga asnjëra**

anë. Kjo është shpallje prej një të Urti, që meriton të gjitha lavdet”.²

“Dhe thuaj: ‘E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë’”.³

Përse e humbasim kohë, duke kërkuar të vërtetat e besimit, ndërkohë që Kur’ani është burimi i gjithçkaje? Ai është burimi, zanafilla dhe pika e fillimit. Ai është konsultuesi kryesor për jetën tonë të përditshme, sepse Allahu thotë në Kur’an: **“O ju që keni besuar! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit, kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë...”**⁴

Kur’ani na sqaron ekzistencën e Allahut, na sqaron jetën dhe legjislacionin përkatës të jetës individuale dhe shoqërore.

Është detyrë madhërimi, lartësimi dhe shenjtërimi i Kur’anit. Gjithashtu, duhet të zbatohet në jetën e përditshme. Ai duhet të jetë pikënisja jonë dhe prej tij të shuajmë etjen e dijes e të njohjes. Të shoqërohemi me të njësoj siç shoqërohemi me një mik të sinqertë e të dashur. Ashtu siç ka shoqëria dhe miqësia e sinqertë rregullat e saj, po ashtu, edhe shoqërimi me Kur’anin ka kushtet e mendimit, përsiatjes, ruajtjes dhe zbatimit.

² Sure “El Fusilet”, ajeti 42.

³ Sure “Kehf”, ajeti 29.

⁴ Sure “El Enfal”, ajeti 24.

Nëse do të interesohemi ashtu siç duhet për Kur'anin, padyshim që kemi ndriçuar mendjen dhe shpirtin, kemi pastruar zemrën, kemi përsosur moralin dhe jemi të paluhatshëm para cytjeve të djallit të mallkuar.

Kur'ani duhet të lexohet si libër udhëzimi, sepse ai është Libri që i nxjerr njerëzit nga errësira në dritë. Nuk duhet të nxitohemi në lexim a këndim, siç veprojnë shumica e njerëzve, të cilët interesohen më shumë për përfundimin e shpejtë të leximit të një xhuzi apo të përfundimit sa më shpejt të një hatmeje (leximi i plotë i Kur'anit). Një ajet është më mirë të kuptohet e të zbatohet, se sa dhjetëra e qindra hatme, të cilat nuk ndikojnë në qenien e njeriut. Leximin e shpejtë do ta krahasoja me shikimin nga dritarja e makinës, që ecën shumë shpejt në rrugë. Edhe pse i shohim pamjet e bukura natyrore, shumë shpejt harrohen dhe largohen nga mendja.

Ky është dallimi i leximit të atij që kërkon të udhëzohet me udhëzimin e Kur'anit dhe atij që e lexon dhe nuk udhëzohet. Vërtet, Kur'ani është libri i jetës. Përderisa është i tillë, duhet ta konsiderojmë të gjallë. Nëse e konsiderojmë të ngurtë apo si libër i rëndë mësimi, të cilin duhet ta përfundojmë me përfundimin e vitit shkollor, ai do të harrohet, njësoj siç janë harruar shumë libra shkollorë.

Dikush mund të pyesë: A ka ndonjë libër të plotë e gjithëpërfshirës, që më mëson moralin? Po, ai është Kur'ani.

Kur'ani është libri i moralit, prandaj morali ynë le të jetë Kur'ani.

Sipas transmetimeve islame, thuhet se morali i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë Kur'ani. Ai ka qenë Kur'ani folës. Ai u dërgua që të plotësojë moralet e mira. Ky plotësim u arrit me anë të Kur'anit. Të gjitha virtytet e larta, të cilat urdhëron Kur'ani, kanë qenë të kristalizuara në personalitetin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Prandaj, është detyrë e çdo myslimani që Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ta marrë shembull praktik në jetën e tij dhe jo thjesht të thuhet: 'Jam në rrugën e Profetit'.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”.**⁵

O motër dhe vëlla mysliman! Lexojeni Kur'anin dhe kuptojeni atë. Nëse e bëni këtë, atëherë do të kuptoni veten, gjithësinë dhe Krijuesin e gjithçkaje. Kur'anin mund ta krahasojmë me shiun, me anë të të cilit disa toka përfitojnë prej tij dhe japin prodhime të shumta, ndërsa disa toka të tjera nuk përfitojnë prej shiut dhe nuk përfitohet prej tyre, siç është shkretëtira. Vallë, a doni të jeni si toka pjellore apo si shkretëtira e thatë?

⁵ Sure “El Ahzab”, ajeti 21.

Çdo njeri ka nevojë për mësimet e Kur'anit, veçanërisht në këtë kohë që jetojmë, ku virtytet e larta dhe moralet e pëlqyeshme kanë mbetur thjesht bojë mbi letra apo fjalë në majën e gjuhës për interesa të ngushta personale. Sa mirë do të ishte sikur njerëzit ta lexonin suren "Jusuf", suren "Nur", suren "Lukman" dhe suren "Huxhurat", të cilat flasin për moralin, sjelljen dhe edukimin, për të cilat kanë nevojë të gjithë njerëzit pa dallim moshe.

Sa nevojë ka rinia e sotme të njihet me historitë e të rinjve në Kur'an, si: historia e Ismailit me babanë e tij, Ibrahimin, historia e Nuhut me djalin e tij, historia e të rinjve prej banorëve të shpellës etj. Po ashtu, të rinjtë dhe të rejt, të cilët janë e ardhmja e kombit, duhet të njihen edhe me ajetet që flasin për shokun apo shoqen, siç është thënia e Allahut të Madhëruar: **"Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kur'ani) që më kishte ardhur! Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës".**⁶

Dhe: **"Atë Ditë, miqtë do të bëhen armiq të njërit-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë Allahun".**⁷ Sa të mrekullueshme janë këto dy ajete. Ah sikur të lexohen, të kuptohen dhe të zbatohen!

Me rastin e ditëlindjes së Dritës së pashuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen*

⁶ Sure "Furkan", ajetet 28-29.

⁷ Sure "Zuhruf", ajeti 67.

e tij!), Fondacioni i Kur'anit ka përgatitur për besimtarët librin “Mësimet nga surja “Jâ Sîn””.

Qëllimi i përgatitjes së këtij libri është që besimtarët të njihen sa më shumë me përmbajtjen e kësaj sureje të begatë, e cila quhet ndryshe “zemra e Kur'anit” dhe mësimet e saj t'i zbatojnë në jetën e tyre të përditshme.

Allahu i shpërbleftë të gjithë ata që bashkëpunuan në përgatitjen e këtij libri! Allahu i shpërbleftë me të mirat e Tij në këtë jetë dhe i dhuroftë atyre shefatin (ndërmjetësimin) e Kur'anit në Jetën Tjetër!

O Zot, na e mundëso leximin, kuptimin dhe zbatimin e Kur'anit! Na i ndriço rrugët e jetës sonë me dritën e Kur'anit!

Drejtori i Fondacionit të Kur'anit
Haxhi Sheh Vullnet Merja

MËSIMET NGA SURJA "JÂ SÎN"

Allahu i Madhëruar, në ajetin 23 të sures "Ez-Zumer" thotë:

"اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُّتَشَابِهًا مَّثَانِيَ تَقْشَعِرُّ مِنْهُ جُلُودُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ ۚ ذَٰلِكَ هُدَىٰ اللَّهِ يَهْدِي بِهِ مَن يَشَاءُ ۚ وَمَن يُضْلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِن هَادٍ" (سورة الزمر، الآية: 23).

"Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu. Ky Libër është udhëzim i Allahut. Nëpërmjet tij Allahu udhëzon kë të dojë. Ndërsa atë që Allahu e shpie në humbje, s'mund ta udhëzojë kush".

Pas paraqitjes së mësimëve në suret e shkurtra të Kur'anit, në këtë material do të pasqyrojmë mësimet që përmban surja "Jâ Sîn". Sipas renditjes së tubimit, është surja e 36-të; sipas zbritjes, është surja e 40-të dhe ka zbritur pas sures "Xhin" dhe para sures "El Furkan". Kjo sure ka 83 ajete.

Surja “Jâ Sîn” ka zbritur në Mekë. Në përgjithësi, të gjitha suret e zbritura në Mekë kanë të njëjtën përmbajtje dhe flasin për Njëtimin e Allahut (teuhidin), për Ringjalljen pas vdekjes, për profecinë, për Kur’anin. Në këtë sure ka paralajmërime dhe përgëzime.

Përmbajtja e sures “Jâ Sîn” zgjon prej gjumit të shkujdesjes, fut në shpirt besimin, nxit frymën e përgjegjësisë dhe bën thirrje për përkushtim. Kur njeriu mendon rreth këtij argumenti dhe e vë në qendër të mendimit të tij, atëherë hija e këtij mendimi do të ndihet mbi punët e tij dhe pa dyshim që do të arrijë të fitojë jo vetëm mirësitë e kësaj bote, por edhe mirësitë e Botës Tjetër.

MIRËSITË E SURES “JÂ SÎN”

Hadithet dhe transmetimet e shumta që kanë ardhur, në lidhje me mirësitë e kësaj sureje, dëshmojnë se kjo sure, është quajtur “zemra e Kur’anit”. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Çdo gjë ka një zemër dhe zemra e Kur’anit është surja “Jâ Sîn”.

Në një transmetim të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Çdo gjë ka një zemër dhe zemra e Kur’anit është surja “Jâ Sîn”. Kush e lexon këtë sure ditën, para se të erret, atë ditë ai është prej të ruajturve dhe të furnizuarve, derisa të erret; kush e lexon këtë sure natën, para se të bjerë për të fjetur, një mijë

engjëj urdhërohen ta ruajnë atë, në atë natë, prej djallit të mallkuar dhe prej të gjitha sëmundjeve..."

Kjo sure, si të njëzetë e tetë suret e tjera të Kur'anit, që fillojnë me germa të ndara, fillon me dy germa të ndara, fillon me germën: "سین" - "S" dhe me germën "ياء" - "J". Menjëherë pas këtyre dy germave të ndara, si në të gjitha suret që fillojnë me germa të ndara, vjen biseda për Kur'anin famëlartë. Surja fillon me betimin në Kur'an: ***"Për Kur'anin plot urtësi!"***

Në disa hadithe ka ardhur se fjala "Jâ Sîn" është një prej emrave të të Dërguarit më të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Për këtë, në një hadith të ardhur nga Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: *"Surja "Jâ Sîn", është një prej emrave të të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar: "Me të vërtetë ti (Muhamed) je prej të Dërguarve. Je në Rrugën e drejtë".*

Në këtë material do të flasim për mësimet që përmbajnë ajetet e kësaj sureje.

AJETET 1 - 4

Në katër ajetet e para, thuhet:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

يَس وَالْقُرْآنِ الْحَكِيمِ إِنَّكَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَ عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

1. Jâ Sîn.

2. Për Kur'anin plot urtësi!

3. Në të vërtetë, ti (Muhamed) je një nga të dërguarit

4. në rrugë të drejtë

Nga këto ajete mësojmë:

1- Betimet ku'ranore gjithmonë kanë dy dobi kryesore.

Dobia e parë: Theksi vihet mbi objektin për të cilin bëhet betimi.

Dobia e dytë: Shpjegohet madhësia dhe rëndësia e sendit për të cilin betohet Allahu i Lartësuar. Në të vërtetë, betimi zakonisht nuk bëhet mbi gjëra pa vlerë.

2- Betimi i Allahut në Kur'an tregon madhështinë e Kur'anit dhe shenjtërinë e tij.

3- Në Kur'an nuk ka rrugë të shtrembëta, të kota, të pavërteta, sepse Kur'ani është i pacenueshëm dhe i mbushur plot me urtësi.

4- Përballë akuzave që jobesimtarët i bënin Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke i thënë poet i çmendur, magjistar etj, Allahu pohon në këtë sure profetësinë e tij nëpërmjet betimit në Kur'an.

5- Njerëzit e zgjedhur të Allahut dhe të dashurit e Tij gjithmonë janë të shoqëruar nga engjëjt.

6- Rruga e profetëve është rruga e Allahut. Rruga e drejtë është rruga e Allahut dhe e profetëve.

7- Për të arritur suksesin, duhet të sigurohen tri gjëra:

A- Programi i detajuar, që është Kur'ani plot urtësi.

B- Udhëheqësi, që është Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **"Në të vërtetë, ti (Muhamed) je një nga të Dërguarit".**

C- Rrugë e drejtë që është Rrugë e Krijuesit.

8- Baza e besimit duhet të jetë e fortë. Ne besojmë në Allahun e Urtë në Kur'anin plot urtësi dhe në Profetin Muhamed, mësuesin e urtësisë.

9- Sipas ajeteve të Kur'anit, rruga e Drejtë është feja e teuhidit dhe zbatimi i urdhrave të Allahut, mirëpo në Kur'an përmendet me fraza të ndryshme. Ajo është feja e vërtetë dhe vija e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*), mohimi i të gjitha llojeve të politeizmit, siç thuhet në thënien e Allahut në Kur'an: **“Thuaj: Mua më udhëzoi Allahu në rrugën e drejtë dhe nuk ka qenë prej politeistëve”**.

AJETET 5 - 9

Në ajetet 5-9 thuhet:

تَنْزِيلَ الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ
لِنُنْذِرَ قَوْمًا مَّا أُنْذِرَ آبَاؤُهُمْ فَهُمْ غَافِلُونَ
لَقَدْ حَقَّ الْقَوْلُ عَلَى أَكْثَرِهِمْ فَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ
إِنَّا جَعَلْنَا فِيْ أَعْنَاقِهِمْ أَغْلَالًا فَهِيَ إِلَى الْأَذْقَانِ فَهُمْ مُّثْمَرُونَ
وَجَعَلْنَا مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ سَدًّا وَمِنْ خَلْفِهِمْ سَدًّا فَأَغْشَيْنَاهُمْ فَهُمْ لَا يُبْصِرُونَ

5. me Shpalljen e të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit,

6. që të paralajmërosh një popull, paraardhësit e të cilit nuk ishin të paralajmëruar, prandaj këta janë të pakujdesshëm.

7. Shumica e tyre meritojnë dënimin Tonë, se ata nuk besojnë.

8. Ne do t'u vëmë në qafë vargonj, të cilët do t'u arrijnë deri në mjekër, e kështu do të jenë si të mpirë.

9. Ne kemi vënë pengesë para tyre dhe pas tyre e i kemi mbuluar, kështu që ata nuk shohin.

Në ajetet 15-16 të sures “El Maide” thuhet:

قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ * يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur’ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë”.

Të dashur vëllezër dhe motra!

Kur’ani është shpallur nga Allahu për të qenë mënyrë jetese dhe udhërrëfyese për njerëzit në përgjithësi dhe udhërrëfyese për në rrugën më të drejtë dhe më të suksesshme.

Sa më shumë që i afrohemi Kur’anit dhe sa më shumë i përmbahemi atij në lexim, meditim dhe veprim, aq më shumë i marrim begatitë e tij. Sa më shumë largohemi nga Kur’ani, aq më shumë shqetësime dhe brenga na rrethojnë dhe aq më shumë na shtrëngohet zemra dhe na pushtojnë pikëllimet.

Kush nuk ndjek Kur'anin, do ta humbë jetën, të ardhmen dhe fatin e tij dhe do të ecë në errësirën e injorancës, të devijimit dhe të humbjes. Në ajetin 124 të sures "Ta Ha" Allahu i Madhëruar thotë:

وَمَنْ أَعْرَضَ عَنْ ذِكْرِي فَإِنَّ لَهُ مَعِيشَةً ضَنْكًا وَنَحْشُرُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَعْمَى {طه:124}

"Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër".

Nga këto ajete mësojmë:

1- Allahu është i plotfuqishëm për gjithçka dhe mbi gjithçka. Gjithashtu, Ai është i Gjithëmëshirshëm dhe mëshira e Tij përfshin gjithçka. Në ajetin 54 të sures "El En'am" thuhet: "Ketebe ala nefsihî Rahmeh"- **"...Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën..."**.

Ndërsa në ajetin 156 të sures "El A'raf" thuhet: "Rahmeti uestiat kule shej'in"-

"... mëshira Ime përfshin çdo gjë...".

2- Burimi i zbritjes së Kur'anit është fuqia e Allahut dhe mëshira e Tij. Kushdo që kapet pas Kur'anit, është i kapur me fuqinë dhe mëshirën e Allahut.

3- Paralajmërimi ishte një prej qëllimeve të dërgimit të profetëve për t'i paralajmëruar njerëzit nga rreziku i mosbesimit, i devijimit dhe i bërjes së punëve të këqija, të ndyta e shkatërruese. Në Kur'an, fjala "paralajmërim", me të gjitha format e saj, përmendet 126 herë.

4- Paralajmërimi është një ligj i Allahut, i cili ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë dhe nuk është i kufizuar me kohën e as me vendin.

5- Baza, themeli dhe shtylla e predikimit dhe e paralajmërimit janë mësimet e Kur'anit, i cili udhëzon në atë që është më e mira.

6- Paralajmërimi i Kur'anit bazohet në mëshirë.

7- Shumica e njerëzve janë të shkujdesur e të pavëmendshëm ndaj Krijuesit të tyre ndaj vetave të tyre, ndaj përgjegjësive të tyre, ndaj veprave të tyre... etj.

8- Kundërshtimi i shumicës nuk duhet ta thyejë predikuesin dhe thirrësin në rrugën e Allahut nga misioni i tij.

9- Shkujdesja është shkak i mosbesimit, siç thonë ajetet në fjalë: ata janë të shkujdesur, ata nuk besojnë.

10- Edhe pse ajeti thotë se Allahu u vendos jobesimtarëve pranga, zinxhirë, në realitet, janë vetë jobesimtarët që i vendosin prangat në qafat e tyre, për shkak

të mosbesimit dhe të bërjes së mëkateve dhe veprave të këqija.

11- Edhe pse Kur'ani është i pacenueshëm e plot urtësi, edhe pse mesazhi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është absolutisht i vërtetë, edhe rruga e fesë është rruga e drejtë dhe Allahu është i Plotfuqishëm, i Gjithëmëshirshëm, megjithëkëtë shumica e njerëzve janë të shkujdesur, nuk besojnë, janë të lidhur pas legjendave. Kështu që kudo e ngado që të shkojnë, rruga e tyre do të jetë pa krye.

12- Me gjithë praninë e qindra ndriçuesve, që ia ndriçojnë njeriut rrugën, që të mos humbasë, njeriu këmbëngul në qëndrimin e tij në errësirë dhe në rrugëtimin e tij humbës e pa krye.

13- Të shkujdesurit jobesimtarë nuk mësojnë nga ato që pësuan jobesimtarët e shkuar. Po ashtu, nuk i kushtojnë vëmendje mrekullisë dhe argumentit që ndodhet në mesin e tyre, që është Fjala e Allahut, Kur'ani i shenjtë. Kështu që ata janë në rrugë të shtrembër e të mbyllur.

14- Një nga metodat e predikimit dhe të thirrjes në Rrugën e Allahut është përngjasimi i gjërave perceptuese me gjërat e prekshme. Siç shohim në Kur'an, Xheneti përshkruhet duke e krahasuar me një kopsht me gjelbërim e i lulëzuar, në të cilin rrjedhin lumenj me ujë të kulluar.

Të dashur vëllezër dhe motra!

Le të lutemi siç lutej Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili, në një lutje të tij, thoshte: “O Zot, bëje Kur’anin madhështor, pranverë të zemrave tona, dritë në krahavorët tanë, largues të pikëllimeve, brengave dhe shqetësimeve tona”.

AJETET 10 - 11

Në ajetin 88 të sures "Isra", Allahu i Madhëruar thotë:

{قُلْ لَّيْنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَى أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا }

"Thuaj: "Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin".

Kur'ani është një mrekulli që do të zgjasë për aq kohë sa të ketë jetë në tokë. Allahu i Madhëruar, me anë të Kur'anit, e mbështeti të Dërguarin e Tij, Muhamedin dhe e sfidoi njerëzimin dhe xhindet, që të sjellin një sure të ngjashme me të. Paaftësia e folësve elokuentë, të shkuar dhe të sotëm, është dëshmia më e madhe se Kur'ani është fjala e Zotit të botëve, të cilit nuk i vjen e kota nga asnjë anë dhe se ai është mëshirë, shërim dhe udhëzim për mbarë njerëzit.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë për Kur'anin: *"Ai është litari i fortë i Allahut dhe këshillë e urtë; është rruga e drejtë; me të, zemrat nuk largohen nga rruga e drejtë; prej tij nuk ngatërrohen gjuhët; dijetarët nuk ngopen me të; nuk i ikën kënaqësia kur lexohet dhe, kur dëgjohet vazhdimisht, mrekullitë e Tij nuk mbarojnë kurrë..."*

Në ajetet 10-11, Allahu i Gjithëdijshtëm e Mëshirëplotë thotë:

وَسَوَاءٌ عَلَيْهِمْ أُنْزِلَتْهُمْ أَمْ لَمْ تُنْزِلْهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ

إِنَّمَا تُنْذِرُ مَنِ اتَّبَعَ الذِّكْرَ وَخَشِيَ الرَّحْمَنَ الْغَيْبِ فَكَثِيرٌ مِّنْ مَّغْفِرَةٍ وَأَجْرٌ كَرِيمٌ

10. “Për ata është njëlloj, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove, ata nuk besojnë.

11. Në të vërtetë, paralajmërimi yt i sjell dobi vetëm atij që ndjek Këshillën (Kur'anin) dhe i frikësohet të Gjithëmëshirshmit, edhe pa e parë Atë. Këtij jepi lajmin e mirë për falje gjynahesh dhe shpërblim bujar!"

Para se të flasim për mësimet që përmbajnë ajetet 10 dhe 11, rikujtojmë se çfarë thuhet në dhjetë ajetet e para të sures “Jâ Sîn”. Në këto ajete flitet për atë grup njerëzish që nuk janë të gatshëm të pranojnë paralajmërimet e Allahut, prandaj për ata janë të barabartë si paralajmërimi, ashtu edhe mosparalajmërimi.

Ndërsa në ajetin 11, flitet për një grup tjetër njerëzish, që nuk janë të njëjtë me grupin për të cilën flasin ajetet 1-10 dhe, sipas metodës shpjeguese të Kur'anit, kjo mënyrë shpalosjeje bëhet me qëllim që të qartësohet kërkesa për të bërë krahasimin mes dy shtresave.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Kuptimi i fjalës “dhikër”, që përmendet në ajetin 11, është për Kur’anin. Kjo është e njëjtë me thënien e Allahut në ajetin 9 të sures “El Hixhr”: “Inna nahu nëzzlna dhikr ue inna lehu lehafidhune”. - **“Por ata talleshin me çdo të dërguar që u vinte”**.

2- Disa jobesimtarë dhe idhujtarë nuk kanë asnjë grimcë gatishmërie për t’u udhëzuar. Ata janë gjithmonë këmbëngulës në mosbesimin dhe idhujtarinë e tyre dhe paralajmërimet nuk ndikojnë te ata. Për jobesimtarët, në ajetin 6 të sures “El Bekare” thuhet: **“Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë”**. Ndërsa për mushrikët, në ajetin 193 të sures “El A’raf” thuhet: **“Edhe nëse i thirrni në rrugën e drejtë, ata nuk do t’ju ndjekin. Prandaj njësoj është - i thirrët apo nuk i thirrët”**.

3- Zemërziut dhe zemërgurit nuk i bën dobi këshilla. Ai është njësoj si shkëmbi, të cilit i ngul gozhdën. Sado ndikuese të jetë fjala jote në zemër dhe sido që të jetë ndikimi i Shpalljes qiellore, ato nuk do të kenë asnjë ndikim, kur nuk gjejnë mjedisin e përshtatshëm, veçanërisht te zemërgurët. Dihet që, sikur mbi këtë mjedis me tokë të kripëzuar, të shndrisë dielli për mijëra vjet dhe mbi këtë tokë të binin shirat e begatë, apo mbi atë tokë të frynte gjithmonë flladi i pranverës, prej asaj toke nuk do të mbinte asnjë lloj bime, përveç shkurreve e gjembaçëve, pasi pranimi, nga ana e

pranuesit, është kusht që të jetë së bashku me veprimtarinë e vepruesit.

4- Edhe nëse te disa njerëz nuk ka dobi ndikimi i këshillës dhe i paralajmërimit, asnjëherë nuk duhet hequr dorë nga këshillimi dhe paralajmërimi, me qëllim që atyre të mos u lihet hapësirë për të shfajësuar veten e tyre e të thonë se nuk u paralajmëruam e nuk u këshilluam.

5- Kur'ani i shenjtë është baza e përmendjes. Ndjekja e tij e bën njeriun që të kujtojë atë që harron dhe Kur'ani e zgjon zemrën dhe mendjen e njeriut nga gjumi i shkujdesjes.

6- Mëshirë e gjerë e Allahut nuk do të thotë që ne të mos i frikësohemi Atij. Ka shumë njerëz, që kur i këshillon dhe i paralajmëron për rrezikun e një pune të keqe, thonë: Allahu është mëshirëmadh.

7- Besimi në gajbin është shenjë e besimit dhe e frikës së vërtetë.

8- Duhet që frika dhe shpresa të jenë gjithmonë me njëra-tjetrën. Pra, njeriu t'i frikësohet Allahut dhe të shpresojë në mëshirën e Tij.

9- Frika ndaj Allahut është më e rëndësishme në fshehtësi dhe jo në dukje dhe në sy të njerëzve, siç thuhet në ajetin 11: **"...dhe i frikësohet të Gjithëmëshirshmit, edhe pa e parë Atë..."**

10- Detyra e profetëve dhe e të dërguarve është këshillimi, paralajmërimi dhe jo detyrimi. Në ajetet 21 dhe 22 të sures "El Gashije" thuhet: **"Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!"**

11- Përgëzimi për Xhenet u jepet atyre që i zbatojnë paralajmërimet e profetëve:

إِنَّمَا تُنذِرُ مَنِ اتَّبَعَ الذِّكْرَ وَخَشِيَ الرَّحْمَنَ الْعَلِيمَ فَبَشِّرْهُ بِمَغْفِرَةٍ وَأَجْرٍ كَرِيمٍ

"Në të vërtetë, paralajmërimi yt i sjell dobi vetëm atij që ndjek Këshillën (Kur'anin) dhe i frikësohet të Gjithëmëshirshmit, edhe pa e parë Atë. Këtij jepi lajmin e mirë për falje gjynahesh dhe shpërblim bujar!"

Në këtë ajet, janë përmendur dy cilësi të njerëzve që ndjekin këshillat dhe paralajmërimet e Allahut. Këto dy cilësi janë: ndjekja e Kur'anit dhe frika ndaj Allahut.

Nëse myslimanët duan mirësi, drejtësi dhe lavdi për veten dhe umetin e tyre, ata duhet të ndjekin udhëzimin e Kur'anit, fjalën dhe veprën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të familjes së tij të pastër dhe të shokëve të tij të zgjedhur.

AJETI 12

Në ajetin 19 të sures “El En’am” Allahu i Madhëruar thotë:

وَأُوحِيَ إِلَيَّ هَذَا الْقُرْآنُ لِأُنذِرَكُمْ بِهِ وَمَنْ بَلَغَ

“...Ky Kur’an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet...”

Kur’ani, kurrë nuk mund të jetë krijimtari e mendjes së njeriut, veçanërisht në ato rrethana kohore dhe vendore. Fjalët e tij janë mrekulli, po ashtu edhe kuptimet e tij. Kjo dëshmon qartazi se Kur’ani është Fjala e Allahut të Gjithëditur e të Urtë.

Nga kjo fjali e ajetit, gjithashtu, përfitohet se Kur’ani është mrekullia më e madhe dhe dëshmuesi më i madh për vërtetësinë e thirrjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kjo fjali e këtij ajeti ka kuptimin se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është dërguar për të gjithë ata që u mbërrin shpallja dhe mesazhi i tij. E kjo përfshin të gjithë ata që jetojnë në këtë jetë, deri në fund të saj.

Transmetimet e ardhura nga Ehli Bejti thonë se kuptimi i shpalljes së Kur'anit nuk është i kufizuar vetëm me mbërritjen e tekstit të tij te popujt, por përfshin edhe mbërritjen e përkthimit të tij në gjuhë të ndryshme.

Në këtë ajet, Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّا نَحْنُ نُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَنَكْتُبُ مَا قَدَّمُوا وَآثَرَهُمْ وَكُلُّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ فِي إِمَامٍ مُّبِينٍ

"Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre. Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një Libër të qartë".

Në një hadith lexojmë se fisi Beni Seleme banonte në periferi të Medines dhe deshi të shpërngulej afër xhamisë. Me këtë rast, zbriti ajeti: *"Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre"*. Atëherë i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: *"Gjurmët tuaja shkruhen"*, domethënë: shkruhen hapat që ju hidhni për të ardhur në xhami dhe për ato do të shpërbleheni. Pas kësaj fjale, ata nuk u shpërngulën.

Nga ky ajet mësojmë:

1- Të gjithë të vdekurit do të ringjallen në Ditën e Kiametit, siç thotë ajeti në fjalë: **"Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit..."**

2- Libri i veprave e shoqëron njeriun nga vdekja e deri në ringjallje. Prej ajeteve të Kur'anit, mësohet se punët e njerëzve shkruhen dhe ruhen në më shumë se një libër dhe kështu, në Ditën e Llogaridhënies, nuk ka më vend, as për dëshmitarë e as për justifikim.

Libri i parë, është “regjistri i punëve vetjake”, në të cilin janë të numëruara, një për një, të gjitha punët që bën individi gjatë jetës së tij, ashtu siç e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar, në ajetin 14 të sures “El Isrà”: **“Lexoje librin tënd, sot është e mjaftueshme t’i bësh llogarinë vetvetes.”** Atë ditë, britmat e thirrjeve të kriminelëve do të ngrihen në kupën e qiellit. Këtë na e tregon shumë qartë ajeti 49 i sures “El Kehf”: **“Ata do të thonë: ‘Të mjerët ne, si është puna me këtë libër që s’ka lënë (mëkat) as të vogël e as të madh pa e numëruar’”**. Këtë libër, punëmirët do ta marrin në dorën e djathtë, kurse punëkëqijtë e marrin atë në dorën e majtë: **“Ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t’u thotë (njerëzve të tij): ‘Ja, lexoni librin tim!’”**⁸

“Por ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: ‘Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im’.”⁹

Libri i dytë, regjistri i punëve të umetit (bashkësisë së besimtarëve dhe jobesimtarëve). Në këtë libër janë

⁸Sure “El Håkka”, ajeti 19.

⁹Sure “El Håkka”, ajeti 25.

shkruar qartë linjat shoqërore të jetës së umetit, ashtu siç njofton Kur'ani Famëlartë, në ajetin 28 të sures "El Xhàthije": **"...çdo popull do të thirret te libri i vet"**.

Libri i tretë, "el leuhul mahfudh"- "libri i përgjithshëm", i ruajtur, ku janë regjistruar jo vetëm punët e njerëzve të mëparshëm e të mëvonshëm, por të gjitha ngjarjet botërore. Ky libër është një dëshmi tjetër për punët e njerëzve në atë vendgrumbullim të madh. Në të njëjtën kohë, ky libër është udhërrëfyes, edhe për engjëjt e ngarkuar me çështjet e llogaridhënies, si edhe për engjëjt e ngarkuar me zbatimin e vendimit për dhënien e shpërblimit dhe për zbatimin e dënimit

3- Nuk shënohen vetëm veprat në librin e veprave, por shënohen edhe gjurmët e tyre, të mira, siç është sadakaja e vazhdueshme, që përfshin ndërtim rruge, shkolle, spitali, ujësjellësi etj, apo qofshin gjurmë të këqija, siç është ndërtimi i vendeve të degjenerimit e të shkatërrimit moral. Në ditën e Ringjalljes njeriu do të japë llogari për çdo punë dhe gjurmë në këtë dynja.

4- Në Ditën e Ringjalljes do të jepet llogari para Allahut Fuqiplotë. Në ajetet 25-26 të sures "El Gashije" thuhet: **"Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë te Ne dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!"**

5- Besëtytnitë duhen kundërshtuar prerazi dhe nuk duhet bërë lëshime në to, sepse besëtytnitë e largojnë njeriun nga e vërteta dhe e bëjnë që të harrojë Krijuesin e tij.

6- Njeriu nuk është vetëm përgjegjës i veprave të tij, por është përgjegjës edhe i gjurmëve të veprave.

7- Llogaria e Allahut është absolutisht e drejtë, nuk i bën padrejtësi askujt dhe nuk i hyn në hak askujt. Gjithsecili do të marrë atë që ka punuar, pra, do të korrë atë që ka mbjellë në këtë dynja.

8- Gjykata e drejtë e Allahut është e qartë për të gjithë njerëzit në ditën e Llogaridhënies.



AJETET 13 - 17

Në këto ajete, Allahu i Madhëruar, thotë:

وَاضْرِبْ لَهُم مَّثَلًا أَصْحَابَ الْقَرْيَةِ إِذْ جَاءَهَا الْمُرْسَلُونَ

إِذْ أَرْسَلْنَا إِلَيْهِمُ الْمُنِذِرِينَ فَكَذَّبُوهُمَا فَعَمَّزَتَا بِأَيْدِي فَقَالُوا إِنَّا إِلَيْكُمْ مُّرْسَلُونَ

قَالُوا مَا أَنْتُمْ إِلَّا بَشَرٌ مِثْلُنَا وَمَا أَنْزَلَ الرَّحْمَنُ مِنْ شَيْءٍ إِنْ أَنْتُمْ إِلَّا تَكْذِبُونَ

قَالُوا رَبُّنَا يَعْلَمُ إِنَّا إِلَيْكُمْ لَمُرْسَلُونَ

وَمَا عَلَيْنَا إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ

13. Përmendu atyre shembullin e banorëve të qytetit, kur u erdhën të dërguarit.

14. Ne u dërguam atyre dy vetë, që ata i quajtën gënjeshtarë. Pastaj i përforcuam të dërguarit me një të tretë e ata thanë: "Ne, me të vërtetë, jemi dërguar te ju!"

15. Banorët u thanë: "Ju jeni vetëm njerëz si ne, e i Gjithëmëshirshmi nuk ju ka shpallur asgjë; ju vetëm gënjeni".

16. Ata u përgjigjën: "Zoti ynë e di që ne jemi vërtet të dërguar te ju

17. dhe kemi detyrë vetëm që të shpallim qartë".

Në këto ajete tregohet historia e disa profetëve të mëparshëm, të cilët u dërguan për të udhëzuar në rrugën e drejtë adhuruesit e idhujve, që i vinin shok Allahut në adhurim.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Historia e të shkuarve është mësimi më i mirë për të sotmit dhe ata që do të vijnë.

2- Edukuesi dhe predikuesi duhet të ketë njohuri rreth historisë.

3- Shembujt më të mirë janë ata realë dhe jo ata fantazues e të bazuar në iluzione. Të gjithë shembujt që përmend Kur'ani, janë realë e të vërtetë.

4- Ajo që është e rëndësishme të historia, është mësimi që ajo përmban. Ndërsa vendi, populli gjuha apo numri i banorëve në atë vend që ka ndodhur historia, nuk janë të rëndësishme.

5- Të dërguarit shkonin te njerëzit dhe nuk prisnin që njerëzit të shkonin tek ata.

6- Disa njerëz besojnë në ekzistencën e Allahut, mirëpo ata mohojnë profetësinë duke thënë se Allahu na ka

dhënë intelektin dhe nuk kemi nevojë as për profetët e as për shpallje. Sigurisht që ky është besim i gabuar dhe e ka bazën te mosnjohja e Allahut, ashtu siç e meriton, siç thotë ajeti 91 i sures "El En'am": **"Ata nuk e vlerësojnë siç duhet Allahun, kur thonë: 'Allahu nuk i ka zbritur asgjë njeriut'".**

7- Thirrja për në rrugën e vërtetë dhe të urdhëruarit në të mirë e të ndaluarit nga e keqja, ka raste që mund të kërkojë praninë e më shumë se një personi. **"Pastaj i përforcuam të dërguarit me një të tretë".**

8- Kokëfortësia është një sëmundje, për të cilën nuk gjendet ilaç. Për shkak të saj u përgënjeshtroan dhe u mohun të dërguarit.

9- Armiqësia dhe kokëfortësia nuk duhet të jenë shkak që të hiqet dorë nga arritja e qëllimit dhe e synimit. Por duhet të mblidhen të gjitha fuqitë në arritjen e qëllimeve, ashtu siç vepronin të dërguarit e Allahut.

10- Është e mundur që Allahu të dërgojë më shumë se një profet apo të dërguar në një kohë të vetme.

11- Numri i thirrësve dhe i predikuesve të jetë në bazë të nevojës së shoqërisë.

12- Nëse dikujt i ngarkohet një detyrë, ai nuk duhet lënë i vetëm, por duhet mbështetur dhe duhet ndihmuar, siç

thuhet në ajetin 14 të sures që po trajtojmë: **“Pastaj i përforcuam të dërguarit me një të tretë”**.

13- Lartësimi dhe poshtërimi janë në dorën e Allahut, siç thuhet në ajetin 26 të sures “Ali Imran”: **“...Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash...”** Mirëpo nuk duhet harruar se edhe njeriu, me veprat dhe me qëndrimet e tij, e lartëson apo e poshtëron veten e vet.

14- Jobesimtarët nuk arrijnë ta perceptojnë dhe ta kuptojnë shpirtëroren, sepse ata shohin vetëm të dukshmen dhe i quajnë njerëzit të njëjtë, siç thuhet në ajetin 15 prej ajeteve në fjalë: **“Banorët u thanë: ‘Ju jeni vetëm njerëz si ne...’”**

15- Kokëfortësia çon në mohimin e ardhjes së mesazhit. Të tillë ishin, janë dhe do të jenë jobesimtarët kokëfortë e kryeneçë. Në ajetin 15 të ajeteve në fjalë, thuhet: **“...e i Gjithëmëshirshmi nuk ju ka shpallur asgjë; ju vetëm gënjeni”**.

16- Përballë mohimit të vazhdueshëm të jobesimtarëve dhe propagandës së tyre, duhet që zemrat të qetësohen me përmendjen e Allahut dhe të mos bien pre e propagandës devijuese. Duhet të jemi të bindur se Allahu i ka dërguar profetët, siç thotë ajeti 16 prej ajeteve në fjalë: **“Zoti ynë e di që ne jemi vërtet të dërguar te ju”**. Pra, i ka dërguar profetët për të mirën e njerëzve, me qëllim që të ecin në rrugën e mirësisë dhe të largohen nga rruga e keqe.

17- Detyra e profetëve dhe e të dërguarve është përcjellja e mesazhit dhe sqarimi i tij. **"...dhe kemi detyrë vetëm që të përcjellim qartë".**

Në ajetin 40 të sures "Er Rra'ad" thuhet: **"...detyra jote është të kumtosh Shpalljen, se llogaria është te Ne".**

18 - Kur dikush thotë se e ndjek fati i keq, ose kur bëhet pesimist, ose kur begatitë e Allahut largohen prej tij, le ta dijë mirë se shkak për të gjitha këto janë ato që ai mbart në thellësi të shpirtit të tij, janë mendimet e tij të degraduara dhe punët e tij të liga. Ai e ka mbushur botën e tij të brendshme me besimin dhe adhurimin e idhujve, duke ndjekur dëshirat e ulëta dhe duke plotësuar epshet e tij. Kështu që, vetë ai i ka ndërprerë begatitë e Allahut të Lartësuar.

19- Nëse shoqëria ndihet pesimiste, shkakun për këtë është se ajo e tejkalon çdo kufi me mëkatet, e ndot veten me ndyrësinë e imoraliteteve dhe ata që synojnë vetëm punën e mirë në shoqëri tallen, injorohen dhe kërcënohen.

AJETET 18 - 19

Në ajetin 44 të sures “En Nahl”, Allahu i Madhëruar thotë:

بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ

“(Të dërguarit i çuam) **me prova të qarta dhe libra.** Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kur'anin), **me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë”.**

Në këtë ajet, Kur’ani famëlartë i drejtohet Profetit tonë të dashur (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që t’u shpjegojë njerëzve përgjegjësitë e tyre ndaj argumenteve të Zotit të tyre, ndaj të Vërtetit. Ty të kemi zbritur Kur’anin, që t’i shpjegosh qartë mësimet e kuptimet e tij, që me Kur’anin të zgjosh mendimin njerëzor dhe njerëzit të ecin në rrugën e Krijuesit. Kur’ani fton në mendim, arsyetim dhe logjikim.

Në ajetet 18-19 të sures “Jâ Sîn” thuhet:

قَالُوا إِنَّا تَطَيَّرْنَا بِكُمْ لَئِن لَّمْ تَنتَهُوا لَنَرْجِمَنَّكُمْ وَلِنَمَسِّنَنَّكُمْ مِنَّا عَذَابَ أَلِيمٍ

قَالُوا طَائِفًا مِّنْكُمْ أَنزَلَ إِلَهُكُمُ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ أَوَّلَ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلِيُخَرِّجَ الَّذِينَ كَفَرُوا

Banorët thanë: 'Ne parandiejmë fatkeqësi nga ju. Nëse nuk tërhiqeni, do t'ju gurëzojmë dhe me siguri do t'ju godasë një dënim i dhembshëm prej nesh'.

Ata u përgjigjën: 'Fatkeqësia, që ju ndollët, mund të vijë vetëm nga vetja juaj. Vallë, për shkak se po ju këshillojmë, na kërcënoni?! Ju jeni popull që kaloni çdo lloj kufiri'".

Nga këto dy ajete mësojmë:

1- Është detyrë refuzimi i thënieve të kota, bazuar në fakte dhe argumente të qarta. Idhujtarët, jo vetëm që nuk u nënshtruan para kësaj logjike të qartë dhe para atyre mrekullive që panë me sytë e tyre, por e shtuan edhe më shumë ashpërsinë në ballafaqimin e tyre me të dërguarit. Me ashpërsinë që i karakterizonte, arritën deri aty sa i përgënjeshtroan të dërguarit dhe më pas i kërcënuan, se do t'i trajtonin me ashpërsi. E tillë është situata edhe sot, ku thirrësit në rrugën e drejtë fyhen dhe ofendohen nga skllëvërit e dynjasë.

2- Arma e atyre që nuk besojnë, është përgënjeshtrimi, poshtërimi, tallja ofendimi dhe kërcënimi. Ata nuk e njohin butësinë e as dialogun e qetë, për shkak se janë të paditur dhe se mosbesimi e ka errësuar të gjithë qenien e tyre.

3- Kush nuk ka argument të qartë, kapet pas legjendave e besëtytnive.

4- Devijimi mendor është shkak i devijimit praktik.

5- Mosbesimi (kufri) është shkak i ashpërsisë së zemrës dhe i kryeneçësisë ndaj të vërtetës dhe ndjekësve të saj, në krye të të cilëve janë profetët.

6- Jobesimtarët nuk kishin argumente e fakte të qarta për t'u përballur me profetët, për këtë ata strehoheshin të përgënjeshtrimi dhe kërcënimi.

7- Detyra e profetëve është zgjimi i njerëzve nga shkujdesja dhe udhëzimi i tyre në rrugën e paqes, të mirësisë e të drejtësisë.

8- Tejkalimi i kufijve që ka caktuar Allahu, çon në padrejtësi e tirani.

9- Burimi i të keqes është te padrejtësia dhe tirania dhe jo te besimi tek Allahu dhe te profetët.

10- S'ka dyshim se ata që ndjekin rrugën e gabuar, rrugën e mizorisë, të padrejtësisë dhe të shkatërrimit, nuk dëshirojnë të ulen e të diskutojnë me qetësi e me argumente, sepse ata gjithmonë mbështeten te kërcënimet, presionet e dhuna. Këta lloj nuk e kuptojnë se besimtarët e devotshëm e të singertë që ecin në rrugën e Allahut, kurrë nuk gjunjëzohen dhe as nuk dorëzohen para kërcënimeve e presioneve. Ata kanë vazhduar të ecin gjithnjë e më shumë

në rrugën e tyre të drejtë. Këtë e shohim edhe sot në vende të ndryshme islame, ku besimtarët e devotshëm po habisin mbarë botën me besimin, qëndrimin dhe rezistencën e tyre. Fatkeqësitë vijnë nga bërja e mëkateve, gjynaheve, nga padrejtësia e tirania.

Të dashur vëllezër dhe motra! Nëse një mysliman gabon, mëkaton, vjedh apo vret, për këtë nuk duhet fajësuar as Islami, as xhamitë e as hoxhallarët. Çdo njeri është përgjegjës për veprat e tij. Askush nuk e mbart mëkatin e tjetrit. Padituria ndaj legjislacionit islam i shtyn disa njerëz që t'ua heqin frerët gjuhëve të tyre, duke fajësuar fenë për gjynahet që bën një individ, që mbulohet me petkun e fesë për të plotësuar qejfet dhe dëshirat e tij personale.

AJETET 20 - 21

Është transmetuar se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur t’ju mbulojnë sprovat si një pjesë nate e errët, atëherë përmbajuni Kur’anit, sepse ai është ndërmjetësuesi që i pranohet ndërmjetësimi, është dëshmuar dhe vërtetues. Kush e vendos atë (Kur’anin) para tij, do ta çojë në Xhenet e, kush e vendos atë pas tij, do ta çojë në Xhehenem. Ai është treguesi që tregon rrugën më të mirë”.¹⁰

Kjo thënie e të dashurit të zemrave tona, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nxjerr në pah madhështinë e Kur’anit. Ai na porosit që të kapemi pas Kur’anit, që Kur’ani të jetë prijësi ynë në këtë jetë, me qëllim që të bëhet ndërmjetës për ne në Jetën Tjetër.

Në ajetet 20-21 të sures “Jâ Sîn” thuhet:

وَجَاءَ مِنْ أَقْصَى الْمَدِينَةِ رَجُلٌ يَسْعَى قَالَ يَا قَوْمِ اتَّبِعُوا الْمُرْسَلِينَ

اتَّبِعُوا مَنْ لَا يَسْأَلُكُمْ أَجْرًا وَهُمْ مُهْتَدُونَ

Dhe nga skajet e qytetit erdhi një njeri, duke nxituar dhe tha: “O populli im, ndiqni të dërguarit!

¹⁰ “El Kafi”, El Kulejmi, vëll. 2, f. 599.

Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi e që janë në rrugë të drejtë!"

Nga këto ajetet mësojmë:

1- Të jesh larg qytetit nuk do të thotë të jesh larg dijes e kulturës. Ka pasur dhe ka dijetarë, që edhe pse larg qyteteve, ata nuk e privuan veten e tyre nga kërkimi i dijes.

2- Për mbrojtjen e të vërtetës nuk ka kufi e as kohë. E vërteta duhet të mbrohet në çdo vend dhe në çdo kohë.

3- Nganjëherë duhet që njeriu të lëvizë i vetëm për të mbrojtur të vërtetën, siç veproi personi që erdhi nga skaji i qytetit për t'i thënë popullit të tij që të ndjekin të dërguarit. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: "*Mos u frikësoni të ecni në rrugën e udhëzimit, për shkak se jeni pakicë*".

4- Largësia nuk duhet të jetë justifikim për të mos e përkrahur të vërtetën.

5- Mbrojtja dhe përkrahja e të drejtës dhe e të vërtetës duhet të bëhet me vepra dhe jo vetëm me fjalë e me slogane.

6- Mbrojtja e të vërtetës dhe të drejtës duhet të bëhet me vendosmëri, me shpejtësi, me logjikë dhe butësi.

7- Duhet të shembet muri i heshtjes, me anë të së vërtetës e të drejtës, në një mjedis të devijuar, në të cilin sundon padrejtësia, gënjeshtria e trillimi, me qëllim që të mbrohet e vërteta dhe të vërtetët.

8- Singëriteti në thirrje është kusht, me qëllim që njerëzit ta kuptojnë të vërtetën, ta ndjekin dhe ta mbrojnë atë. Ai që thërret tek e vërteta, nuk duhet t'u kërkojë njerëzve shpërblim për këtë. Në ajetin 21 thuhet: ***“Ndigni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi”***.

Çështja e moskërkimit shpërblim nga ana e profetëve për thirrjen që kanë bërë, vetëm në suren “Esh Shuarà” përsëritet pesë herë, në ajetet: 109; 127; 145; 164 dhe 180 të kësaj sureje: ***“dhe për këtë unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim”***.

9- Ai që fton njerëzit në udhëzim, duhet të jetë i udhëzuar. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Kushdo që e vendos veten e tij imam për njerëzit, le të fillojë me edukimin e vetes së tij e pastaj të edukojë të tjerët”*.

10- Banorët e rrethinave kanë gatishmërinë jo vetëm të pranojnë të vërtetën më shumë se banorët e pasur të qendrës së qytetit, por ata besojnë sinqerisht në të vërtetën. Veç kësaj, banorët e rrethinave janë e kundërta e banorëve të qendrave të qyteteve, të cilët e kalojnë jetën në mirëqenie ekonomike, çka e bën të vështirë që ata ta pranojnë thirrjen, për të besuar të vërtetën.

11- Të dërguarit janë të ruajtur nga mëkatet dhe janë të udhëzuar në rrugën e drejtë, siç thuhet në ajetin 21 të sures "Jâ Sîn": **"janë në rrugë të drejtë!"** Ata janë dritë ndriçuese e udhëzuese. Gjithashtu, në ajetet e Kur'anit theksohet edhe singjeriteti e pastërtia e zemrës së profetëve. Për këtë ata janë model për t'u ndjekur, siç thuhet në ajetin 6 të sures "El Mumtehinë":

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِيهِمْ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ

"Vërtet, ata janë një shembull i mirë për ju e për këdo që shpreson në Allahun dhe në Ditën e Fundit..."

AJETET 22-27

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Sigurisht, ky Kur’an është tryeza e Allahut, prandaj, studiojeni sa të mundeni tryezën e Tij”.

Kur’ani është depozita e dijeve të Allahut. Ai që ndriçohet me këtë dije dhe i mbart ato, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mbartësit e Kur’anit janë të diturit e banorëve të Xhenetit”.

Në ajetet 22-27 të sures “Jâ Sîn” thuhet:

وَمَا لِي لَا أُعْبُدَ الَّذِي فَطَرَنِي وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ أَأَتَّخِذُ مِنْ دُونِهِ آلِهَةً إِنْ يُرْزِقِ الرَّحْمَنُ بِضُرٍّ لَا تُغْنِي عَنِّي شَفَاعَتُهُمْ شَيْئًا وَلَا يُنْقِذُونِ إِنْ إِذَا لَفِيَ ضَلَالٍ مُبِينٍ إِنْ آمَنْتُ بِرَبِّكُمْ فَاسْمِعُونِ قِيلَ ادْخُلِ الْجَنَّةَ قَالَ يَا لَيْتَ قَوْمِي يَعْلَمُونَ بِمَا غَفَرَ لِي رَبِّي وَجَعَلَنِي مِنَ الْمُكْرَمِينَ

22. Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë?

23. Vallë, përse duhet të adhuroj zota të tjerë përveç Tij? Nëse i Gjithëmëshirshmi do të dëshironte të më godiste me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i atyre (zotave) nuk do të më sillte kurrfarë dobie e as që do të mund të më shpëtonin.

24. Atëherë, unë do të isha me siguri në humbje të dukshme.

25. Unë i kam besuar Zotit tuaj, andaj, më dëgjoni!"

26. (Pasi e vrau populli i vet, atij) iu tha: "Hyr në Xhenet!" Ai tha: "Ah, sikur ta dinte populli im,

27. se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!"

Këto ajete flasin për besimin te Krijuesi, për Allahun e vetëm e të pashoq dhe për largimin nga adhurimi i idhujve, i cili çon në humbje. Gjithashtu, në këto ajete tregohet qëndrimi i atyre besimtarëve të paktë, që sfiduan mohuesit dhe mbrojtën të dërguarit, deri në frymën e fundit.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Allahu është Krijuesi i gjithçkaje dhe te Ai do të kthehemi. Kushdo që mohon kthimin te Allahu (Ringjalljen), ka mohuar Krijuesin.

2- Ai që meriton të adhurohet, është vetëm Krijuesi, Sunduesi, Dhuruesi dhe jo idhujt, që as nuk dëmtojnë e as nuk sjellin dobi. Natyra e pastër e krijimit u thotë njerëzve: detyra juaj është të adhuronit vetëm Krijuesin dhe jo këto sende të rëndomta, të punuara me duart tuaja. Nëse dikush adhuron dikë tjetër përveç Allahut, vetëkuptohet që ai ka hyrë në rrugën e humbjes, madje në një humbje shumë të madhe.

3- Ai që nuk e adhuron Allahun, atë e dënon ndërgjegjja e tij, e cila është gjykata e brendshme që e shoqëron njeriun gjatë gjithë jetës.

4- Prej metodës së thirrjes së të tjerëve në rrugën e udhëzimit është sqarimi i besimit me argumente të qarta, treguese e logjike. Argumentet më të qarta për këtë çështje gjenden në Kur'anin e shenjtë.

5- Baza e adhurimit është besimi te Allahu, Krijuesi dhe Ringjallësi.

6- Ajeti 23 i vë kufirin pretekstit kryesor të adhuruesve të idhujve, që thoshin: **“Ne i adhurojmë idhujt, me qëllim që idhujt të ndërmjetësojnë për ne te Allahu”**. Me fjalën e tij, ai njeri u thotë atyre: “Çfarë ndërmjetësimi? Çfarë ndihme dhe çfarë shpëtimi prisni prej idhujve? Vetë idhujt kanë nevojë për ju, që t’i ndihmoni e t’i mbronin ata. Çfarë mundësie kanë idhujt, që të bëjnë ndonjë gjë për ju, kur gjendeni në gjendje të rënduar?”.

7- Krijuesi i Gjithëmëshirshëm nuk dëshiron të dëmtohet asnjë njeri, por, kur njeriu, me veprimet e tij, në kundërshtim me urdhrin e Allahut, arrin deri aty sa të dalë jashtë mëshirës së Tij, atëherë ai e ka hedhur veten në rrethin e zemërimit të Allahut.

Si është e mundur, që njeriu, i pajisur me mendje, të arrijë deri aty sa i vë këta trupa të ngurtë krah për krah me Krijuesin e qiejve e të tokës?!

8- Metoda më e mirë për thirrjen e njerëzve është ajo praktike. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Bëhuni thirrës të njerëzve jo me gjuhët tuaja, por me veprat tuaja"*.

9- Fjala luan rol të madh në udhëzimin e njerëzve. Fjala e atij besimtari ishte ndikuese, fjala e tij ishte motiv për entuziazëm, fjala e tij ishte e mbushur me argumente të fuqishme, që nuk mund të kundërshtoheshin, ishte fjalë që depërtonte në zemër. Por fjalët e atij besimtari nuk mund të kishin asnjë ndikim pozitiv mbi ato zemra të zeza, të mbushura vetëm me kurthe e me mashtrime, prandaj ndodhi e kundërta, fjalët e atij besimtari shtuan në zemrat e tyre edhe më shumë urrejtje e zemërim. Në zemrat e atyre mohuesve, fjalët e besimtarit shtuan edhe më shumë flakët e zjarrit të armiqësisë kundër të vërtetës, prandaj, jobesimtarët u hodhën kundër atij njeriu trim dhe e vranë atë në mënyrën më barbare që mund të mendohet. Thuhet se, kur ata e qëllonin atë me gurë, ai thoshte: "O Zoti im, udhëzoje popullin tim në rrugën e drejtë!". Megjithatë ata e vranë njeriun besimtar.

10- Dëshmorët e kanë vendin në Xhenet, siç thuhet në ajetin 26 prej ajeteve në fjalë: "(Pasi e vrau populli i vet, atij) **iu tha: Hyr në Xhenet!**"

11- Para Jetës së Përtejme është jeta e Barzahut (bota e ndërmjetme). Në botën e Barzahut ka një Xhenet dhe një Xhehenem, që janë model i Xhenetit e i Xhehenemit, që do

të shohin njerëzit në Ditën e Gjykimit. Në Kur'anin Famëlartë flitet shpesh për Xhenetin e për Xhehenemin. Në një transmetim të ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë: *“Varri është një kopsht prej kopshteve të Xhenetit, ose është një gropë prej gropave të zjarrit”*.

12- Martirizimi është shkak i faljes së gjynaheve.

13- Shpirti i pastër i besimtarit, pa dyshim që ngrihet pranë mëshirës së Allahut dhe ai fiton mirësitë e Xhenetit. Kur të hyjë në Xhenet, besimtari do të thotë: ***“Ah, sikur ta dinte populli im, se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!”***

Me këto fjalë, besimtari thotë se, sikur ata të kishin sy që shikojnë të vërtetën, do të ishin krejt ndryshe. Por ata sytë i kanë të mbuluara me perden e trashë e të rëndë të interesave të kësaj bote, kështu që ata nuk i shohin dot mirësitë e mëdha dhe respektin që do të kenë prej Allahut të Lartësuar. Besimtari ka dëshirë t’u thotë jobesimtarëve se, sikur ta dini, se me çfarë butësie e dashamirësie më ka rrethuar mua Allahu kundrejt armiqësisë suaj kundër meje. Ah, sikur ata të shihnin dhe të besonin! Por është për të ardhur keq, sepse ata i mashtroi kjo botë dhe ata ia mbyllën dyert zemrave të tyre, duke i lënë ato në errësirë.

Të dashur vëllezër dhe motra, është detyrë që shpirti të lahet me ujin e pendimit e të faljes së mëkateve, që të jetë krejtësisht i pastër prej gjynaheve e mëkateve, pasi vetëm shpirti i pastër zë vendin që i takon në rrethin e afrimit dhe

të nderimit hyjnor. Nderimi shtohet e zmadhohet krahas shtimit të devotshmërisë, ashtu siç e lexojmë këtë të vërtetë në ajetin 13 të sures "El Huxhurât": **"Më i nderuari juaj te Allahu është më i devotshmi prej jush"**.

AJETET 28 - 32

Në ajetet 28-32 thuhet:

وَمَا أُنزِلْنَا عَلَى قَوْمِهِ مِنْ بَعْدِهِ مِنْ جُنْدٍ مِّنَ السَّمَاءِ وَمَا كُنَّا مُنْزِلِينَ إِنْ كَانَتْ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً فَإِذَا هُمْ خَامِدُونَ يَا حَسْرَةً عَلَى الْعِبَادِ مَا يَأْتِيهِمْ مِّن رَّسُولٍ إِلَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ أَلَمْ تَرَوْا كَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُم مِّنَ الْقُرُونِ أَنَّهُمْ إِلَهُمْ لَا يَرْجِعُونَ وَإِنْ كُلٌّ لَّمَّا جَمِيعٌ لَّدَيْنَا مُحْضَرُونَ

28. Por pas (vdekjes së) tij, Ne nuk i dërguam kurrfarë ushtrie nga qielli (si dënim) popullit të tij dhe as që kishte nevojë për të dërguar.

29. (Mjaftoi për t'i dënuar ata) vetëm një zë i tmerrshëm, pas të cilit u shuan përnjëherësh.

30. Ah, sa mjerim për ata njerëz! Kurdo që u vinte ndonjë i dërguar, ata nuk bënë tjetër, por vetëm talleshin me të.

31. Vallë, a nuk e kishin parë ata se sa e sa brezni para tyre që kishim shkatërruar nuk u kthyen më?!

32. Të gjithë ata do të paraqiten bashkërisht te Ne.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mos u bëj i pavëmendshëm ndaj leximit të Kur’anit, sepse Kur’ani ringjall zemrën dhe ndalon nga të këqijat dhe imoraliteti”.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: *"Kushdo që ulet me këtë Kur'an, do ngrihet prej tij me shtim ose me mangësi. Shtim në udhëzim, ose mangësi në verbëri"*.

Nëse ajetet e mëparshme flisnin për përpjekjet e besimtarit për të ndihmuar të dërguarit e Allahut, derisa u martirizuan nga dora e jobesimtarëve kokëfortë, ajetet në fjalë flasin për shkatërrimin dhe fundin e hidhur të jobesimtarëve.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Engjëjt janë urdhëruar ose për ndëshkim, ose për mëshirë. Zbritja dhe ngritja e tyre është me urdhër të Allahut. Në ajetin 6 të sures "Et Tahrîm" thuhet: **"... kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato"**.

2- Ndëshkimi i Allahut vjen papritmas, prandaj duhet të mos jemi të pavëmendshëm. Në ajetin 47 të sures "El En'am" thuhet: **"Thuaj: 'Më thoni, nëse ju vjen dënimi i Allahut papritmas ose sheshazi, a do të zhdukej kush përveç popullit keqbërës?'"**

3- Ka mundësi që një vend të shkatërrohet e të zhduket, për shkak të vrasjes së një besimtari të pafajshëm

apo të një predikuesi të sinqertë të fesë së Allahut, apo të një sakrifikuesi në rrugën e Allahut.

4- Ajo fuqi e madhe e jobesimtarëve, e cila më parë thoshte se: **“Nëse nuk tërhiqeni, do t’ju gurëzojmë dhe me siguri do t’ju godasë një dënim i dhembshëm prej nesh”**, vetëm me një britmë u shuan përnjëherësh. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ai vetëm sa i thotë diçkaje **“Bëhu”** dhe ajo bëhet, siç thuhet në ajetin 82 të sures **“Jâ Sîn”**: **“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj “Bëhu!” - dhe ajo bëhet”**.

5- Ai njeri që ka mundësi të ftojë te e vërteta, të qëndrojë në krah të së vërtetës apo të fitojë lumturinë, duke ndjekur udhëzimet e të dërguarve, përse duhet ta çojë veten e tij në dënim, duke ndjekur kokëfortësinë dhe mosbesimin?!

6- Kokëfortësia është shkak i verbimit ndaj të vërtetës, ndaj rrugës së përsosmërisë dhe është shkak i mjerimit.

7- Njohja e ndodhive të hidhura historike janë mësim dhe siguri për njeriun.

8- Tallja me të dërguarit dhe përgënjeshtrimi i tyre ishte një zakon i jobesimtarëve përgjatë historisë.

9- Gjatë gjithë historisë, të dërguarit u përballen me tallje, ofendime, kërcënime. Prandaj, edhe predikuesit e fesë

së Allahut është e mundur që të përballen me tallje ofendime e kërcënime, siç u përballën të dërguarit e Allahut dhe profetët.

10- Historia duhet të lexohet me arsyetim e përsiatje në të dhe të merret në konsideratë fundi i të mëparshmëve. Nuk duhet të jetë lexim kalimthi.

11- Ndëshkimi i Allahut për popujt mëkatarë është i qëndrueshëm përgjatë historisë. Mirëpo mënyra e ndëshkimit ndryshon, siç thuhet në ajetin 40 te sures "El Ankebut": **"Ne të gjithë i dënuam për gjynahun e vet: disave u dërguam furtunë, disa syresh i goditi një zë i tmerrshëm, disa prej tyre i gëlltiti toka dhe të tjerët i përmbyti uji. Allahu nuk u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes".**

12- Fundi i atyre që tallen me të dërguarit dhe profetët është shkatërrimi dhe dënimi i dhembshëm.

13- Pas zbritjes së ndëshkimit të Allahut nuk është mundësia e kthimit dhe e kompensimit të asaj që shkoi. Njeriu e humb vetë mundësinë e përmirësimit e të rrugëtimit në rrugën e vërtetë e të drejtë. Sa bukur flasin ajetet 99-100 të sures "El Mu'minun" për këtë: **"Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: "O Zoti im, më kthe," "që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!" Kurrresi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë, të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen".**

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Mundësia kalon si retë, ndaj përfitoni nga mundësitë e mira”.

الفرصة تمر مر السحاب، فانتبهوا فرص الخير

14- Shuarja e jobesimtarëve nga kjo jetë nuk është fundi i tyre, por është fillimi i dënimit të tyre: **“Të gjithë ata do të paraqiten bashkërisht te Ne”**.

15- Të gjithë njerëzit në Ditën e Ringjalljes do të tubohen në një vend të përbashkët. Në ajetin 48 të sures “Ibrahim” thuhet:

يَوْمَ يُبَدِّلُ الْأَرْضَ عَيْرَ الْأَرْضِ وَالسَّمَوَاتِ ۖ وَتَرَوُا لِلَّهِ الْوَاحِدِ الْقَهَّارِ

“Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt, të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënjyesit Allah”.

Në ajetet 26 -27 të sures “Et Tekuir” thuhet: **“Prandaj, nga po shkoni? Ai (Kur’ani) është veçse këshillë për botët”**.

AJETET 33- 36

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Zemrat ndryshken njësoj siç ndryshket hekuri".

- O i dërguari i Allahut! - e pyetën. - Cili është pastruesi i tyre?

- Leximi a këndimi i Kur'anit dhe kujtimi i vdekjes.

Tani do të përmendim mësimet që përmbajnë ajetet 33-36 të sures "Jâ Sîn". Në këto ajete, Allahu i Urtë e i Gjithëditur thotë:

وَأَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَكُلُوا مِنْ ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَارْزُقُوا مِنْ ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَارْزُقُوا مِنْ ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ
 مِنَ الْعَالَمِينَ لِيَأْكُلُوا مِنْ ثَمَرِهِ وَمَا عَمِلَتْهُ أَيْدِيهِمْ أَفَلَا يَشْكُرُونَ سُبْحَانَ الَّذِي خَلَقَ الْأَزْوَاجَ كُلَّهَا مِمَّا تُثْبِتُ الْأَرْضُ
 وَمِنْ أَنْفُسِهِمْ وَمِمَّا لَا يَعْلَمُونَ

33. Dhe argument për ata (për fuqinë e Allahut) është toka e vdekur, të cilën Ne e ngjallim dhe prej saj Ne nxjerrim drithëra, prej të cilave ata hanë.

34. Në tokë Ne kemi bërë kopshte prej hurmash e rrushi dhe në të Ne kemi shpërthyer burime uji.

35. Që ata të hanë prej frutave dhe prej asaj që prodhojnë me duart e tyre; përse nuk falënderojnë?

36. I pastër nga të metat është Ai që krijoi çiftet nga ato që mbijnë në tokë, nga vetë ata dhe nga ato që ata nuk i dinë.

Në ajetin 32 të kësaj sureje të begatë, u shpalos çështja e ringjalljes pas vdekjes. Ndërsa ajetet në fjalë, pra, nga ajeti 33 deri te ajeti 36, shpjegohet qartë çështja e Njëtimit të Allahut (Allahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe çështja e ringjalljes pas vdekjes, me qëllim që të zgjohen prej gjumit të shkujdesjes ata njerëz që i mohojnë këto dy të vërteta absolute, si dhe për t'i ndërgjegjësuar ata që të kthejnë sytë e zemrën drejt besimit.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Ringjallja është e pamohueshme. Kur'ani ka argumente për këtë. Prej tyre është mbirja e farës, e cila në dukje duket e pajetë, por, kur hidhet në tokë, me fuqinë e Allahut, ajo mbin. Edhe të vdekurit do të ringjallen nga varret e tyre në Ditën e Kiametit.

2- Për të vërtetuar atë që themi, duhet të kemi fakte dhe shembuj të qartë dhe realë.

3- Argumenti më i mirë për njerëzit është ai i përgjithshmi, i përhershmi (për çdo vend dhe kohë), i thjeshtë dhe i pamohueshëm. Ajeti 33 i ajeteve në fjalë na përmend tokën e vdekur si argument.

4- Kruga më e mirë e besimit në Ringjallje është të menduarit për krijimin. Prej tyre të shohim tokën e vdekur, e cila, me fuqinë e Allahut, ringjallet me mbirjen e bimëve të llojllojshme.

5- Pjesa kryesore e ushqimit të njeriut janë drithërat dhe të menduarit rreth tyre është një portë për njohjen e Allahut. Në ajetin 33 thuhet: ***"Ne nxjerrim drithëra, prej të cilave ata hanë"***.

6- Frutat që përmenden më shumë në Kur'an, janë hurma arabe dhe rrushi. E kjo, së pari, për shkak të lëndëve ushqyese dhe dobive shëndetësore që ato përmbajnë, së dyti, për shkak të llojshmërisë së tyre.

7- Roli kryesor në ushqim janë drithërat, më pas vijnë frutat.

8- Është detyrë e njeriut që ta njohë Krijuesin, Furnizuesin dhe ta falënderojë Atë për gjithçka që i ka dhënë.

9- Përmendja dhe sqarimi i mirësive është shkak i gjetjes së frymës falënderuese të njeriut. **"...përse nuk falënderojnë?"**

10- Të falënderuarit është shenjë e vëmendshmërisë dhe e devotshmërisë. Sigurisht që Allahu nuk ka nevojë për falënderimin tonë.

11- Prej mrekullive të Kur'anit është se ai na flet për ligjin e dyzimit të krijesave, njerëz, kafshë, bimë, pemë. Kur'ani famëlartë, me këtë ajet, njofton për ekzistencën e dukurisë së çiftit në botën e bimësisë, te njeriu dhe te qeniet e tjera, për të cilat njeriu nuk ka dijeni. Këto qenie mund të jenë bimësia dhe dihet sa të shumta janë çiftet në llojet e ndryshme të bimëve, aq sa është e pamundur të dihet prej njeriut, madje në kuptimin e çiftit përfshihen edhe kafshët detare, që jetojnë në thellësi të deteve. Kjo e vërtetë, patjetër që nuk dihej në të kaluarën, madje edhe në kohën e sotme, prej këtyre qenieve njihen fare pak lloje.

12- Ligji i dyzimit nuk është për Allahun, sepse Ai është një i vetëm e i pashoq. Allahu është i pastër nga të gjitha llojet e mangësive e nevojave; gjithashtu, në këtë ajet hidhet poshtë vënia shok Allahut në adhurim (shirku), ashtu siç bëjnë adhuruesit e idhujve, që u përmendën në ajetet e mëparshme. Njëkohësisht, në këtë ajet shpjegohet qartë e gjithë rruga e Njëtimit të Allahut (teuhidit), domethënë rruga e adhurimit kushtuar vetëm Allahut, Zotit Një e të Vetëm, Absolutit, të Cilit i luten të gjitha krijesat për nevojat që kanë. Allahu i Lartësuar i ka krijuar të gjitha llojet e çifteve në këtë botë kaq të gjerë; dituria e fuqia e Tij s'ka kufi. Vetëm Ai është i pastër nga çdo e metë e nevojë, prandaj, për Allahun s'mund të ketë as shok e as të ngjashëm me Të, pavarësisht se disa njerëz e konsiderojnë gurin apo dërrasën, që janë trupa të ngurtë e pa jetë, të barabartë me Allahun e Lartësuar. Megjithatë, ky besim

krejtësisht i gabuar nuk i pakëson asgjë pozitës së madhështisë së Tij.

13- Dija njerëzore është e kufizuar. Ajeti 36 e sqaron, e argumenton se ka edhe shumë të vërteta që deri tani janë të panjohura për dituritë tona: **"I pastër nga të metat është Ai që krijoi çiftet nga ato që mbijnë në tokë, nga vetë ata dhe nga ato që ata nuk i dinë".**

14- Krijimi dhe krijesat janë shenjë e fuqisë, diturisë dhe e urtësisë së Allahut dhe nuk tregojnë nevojën e Allahut për to.

15- Frutat dhe drithërat arrihen nëpërmjet pjalmimit i cili ndihmohet nga era uji dhe insektet.

16- Dituria e njeriut është e kufizuar. Në ajetin 85 të sures "Isra" thuhet: ***"... juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni"***. Ai është i paditur për shumë e shumë gjëra që e rrethojnë. Ka krijesa në këtë botë që njeriu nuk ka dituri se si bëhet çiftëzimi te to.

AJETET 37 - 40

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Zbatoje leximin e Kur’anit, sepse leximi i tij shlyen gjynahet, është mbulim prej zjarrit dhe siguri prej dënimit”.

Në ajetet 37-40 të sures “Jâ Sîn” thuhet:

وَأَيُّهُمْ اللَّيْلُ نَسْلَخُ مِنْهُ النَّهَارَ فَإِذَا هُم مُّظْلِمُونَ وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّ لَّهَا ذَلِكَ تَقْدِيرُ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ وَالْقَمَرَ قَدَرْنَا مَتَّارِلَ حَتَّىٰ عَادَ كَالْعُرْجُونِ الْقَدِيمِ لَا الشَّمْسُ يَنْبَغِي لَهَا أَنْ تُدْرِكَ الْقَمَرَ وَلَا اللَّيْلُ سَابِقُ النَّهَارِ وَكُلٌّ فِي فَلَكٍ يَسْبَحُونَ

37. Një shenjë tjetër për ata është nata, prej së cilës Ne e tërheqim ditën dhe atëherë ata mbeten në errësirë.

38. Dielli sillet në drejtimin e vet të caktuar. Kështu e ka paracaktuar i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshmi.

39. Hënës i kemi caktuar faza; ajo përditë hahet e bëhet si rremi i përkulur i hurmës.

40. As Dielli nuk mund ta arrijë Hënë e as nata nuk mund t’ia kalojë ditës; të gjitha notojnë në orbitat e veta.

Në ajetin 53 të sures “El Fusilet” thuhet:

سُبْحِنَهُمْ أَيْدِينَا فِي أَلْعَافَاكِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَّبِعِنَ لَهُمْ اللَّهُ الْحَقُّ ۖ أَوَلَمْ يَكُنْ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ

"Ne do t'u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur'ani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?!"

Këto ajete të begata të sures "Jâ Sîn" flasin për argumente nga hapësira qiellore, që dëshmojnë madhështinë e fuqisë së Allahut.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Nata dhe dita janë shenjë dhe argument i fuqisë së Allahut dhe i urtësisë së Tij. Po ashtu, janë mirësi e madhe për njeriun.

2- Programi konstant, pa asnjë mangësi e gabim, për gjatë historisë është tregues i pranisë së Administruesit, Rregulluesit dhe Sunduesit të Urtë të Gjithëdijshëm e të Plotfuqishëm dhe nuk është natyra e pafuqishme.

3- Ardhja e ditës dhe e natës nuk ndodh vetvetiu, por ndodh si shkak i administrimit të Krijuesit të Plotfuqishëm. *Një shenjë tjetër për ata është nata, prej së cilës Ne e tërheqim ditën.* Në ajetet 71-72 sqarohet më së miri kjo çështje, ku Allahu thotë:

قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ اللَّيْلَ سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ مَنْ إِلَهٌ غَيْرُ اللَّهِ يَأْتِيكُم بِضِيَاءٍ أَفَلَا تَسْمَعُونَ قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ جَعَلَ اللَّهُ عَلَيْكُمُ النَّهَارَ سَرْمَدًا إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ مَنْ إِلَهٌ غَيْرُ اللَّهِ يَأْتِيكُم بِلَيْلٍ تَسْكُنُونَ فِيهِ أَفَلَا تُبْصِرُونَ

“ Thuaju (o Muhamed): ‘Pa mendoni, nëse Allahu jua bën natën të përhershme deri në Ditën e Kiametit, cili zot, përveç Tij, do t’jua sillte dritën? Vallë, a nuk dëgjoni?’

Thuaju (o Muhamed): ‘Pa mendoni, nëse Allahu jua bën ditën të përhershme deri në Ditën e Kiametit, cili zot, përveç Tij, do t’jua sillte natën, në të cilën qetësoheni? Vallë, a nuk shihni?’”

4- Orbita e lëvizjes së Diellit dhe Hënës është sistemuar në atë mënyrë që ato të mos përplasen gjatë lëvizjes së tyre dhe as të mos ketë gabim në lëvizjen e natës e të ditës. Ajeti 40 prej ajeteve në fjalë thotë: **“As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën e as nata nuk mund t’ia kalojë ditës; të gjitha lundrojnë në orbitat e veta”**.

5- Ndryshe nga pikëpamja që e konsideronte diellin të palëvizshëm, Kur’ani na flet për lëvizjen e diellit në mënyrë të përcaktuar. Këtë e dëshmon ajeti 38 i sures “Jâ Sîn”: **“Dielli sillet në drejtimin e vet të caktuar. Kështu e ka paracaktuar i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshti”**.

6- Qoftë drita, qoftë errësira, çdonjëra, në vetvete, është një argument i madh i Allahut. Në të vërtetë, errësira konsiderohet prej dukurive jetësore më të rëndësishme në jetën e njeriut, sepse errësira e natës rregullon dritën e Diellit dhe ka ndikim të thellë në qetësimin e trupit e të shpirtit të

njeriut, ndalon rrezet e shumta që vijnë nga drita e vazhdueshme dhe e pandërprerë e rrezeve të Diellit. Nëse nata nuk do të vinte pas ditës, patjetër që shkalla e nxehtësisë do të ngrihej shumë në sipërfaqen e Tokës, madje do të ngrihej aq shumë, sa të gjitha sendet do të merrnin flakë e do të digjeshin. Kështu ndodh edhe me dritën e hënës, me natën e ditët e saj të gjata (çdo natë atje është afërsisht pesëmbëdhjetë ditë e net që janë në Tokë, e njëjtë është gjendja në raport edhe me ditën); pra, nëse nuk do të ishte ndërthurja ditë-natë, do të kishim ose nxehtësi vrastare, ose ngricë të plotë.

7- Askush nuk mund të shkaktojë parregullsi në sistemin e gjithësisë, sepse ky sistem është i caktuar nga Allahu i Plotfuqishëm.

8- Shembujt e Kur'anit janë të përkryer e realë. Në ajetin 39 prej ajeteve në fjalë e ngjason hënën me bistakun e thatë të hurmës. Në të vërtetë, bistaku i hurmës së pjekur ngjan nga disa anë me hënën nga forma harkore dhe nga ngjyra e verdhë e venitur, me dy majat e ulura nga poshtë, si dhe nga qenia e bistakut të hurmës në mes të një errësire të shkaktuar prej degëve të gjelbra e të dendura të drurit të hurmës.

Nga kjo pikëpamje, ngjan me hënën në qiellin e errët. I Gjithëfuqishmi, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s'ka nevojë për asgjë, vetëm në një shprehje kaq të shkurtër ka futur këtë dukuri astronomike me bukuri mahnitëse.

9- Gjithçka në univers lëviz në orbitën e saj.

10- Lëvizja e galaktikave në univers është e shpejtë. Këtë e tregon edhe fjala “jusbehune”, e cila simbolizon lëvizjen e shpejtë.

AJETET 41 - 44

Allahu i Madhëruar, në ajeti 104 të sures "El En'am" thotë:

قَدْ جَاءَكُمْ بَصَائِرُ مِنْ رَبِّكُمْ ۖ فَمَنْ أَبْصَرَ فَلِنَفْسِهِ ۖ وَمَنْ عَمِيَ فَعَلَيْهَا ۚ وَمَا أَنَا عَلَيْكُمْ بِحَفِيظٍ

“(Thuaju o Muhamed): **Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj**”.

Jeta në këtë botë është e shkurtër. Errësitat e kësaj jete janë të shumta. Kështu që njeriu ka nevojë për udhëzues, që ta udhëzojë në ligjet e jetës, në natyrën e saj, në sistemin e saj dhe në krijesat rreth tij. Gjithashtu, ka nevojë për mësues, që ta mësojë se si të bashkëpunojë me veten dhe me të tjerët. Kur’ani është udhëzuesi, mësuesi, drita dhe ndriçuesi i përkryer. Allahu thotë: **“Në të vërtetë, ky Kur’an udhëzon drejt asaj që është më e mira...”**¹¹

Ai është e vërteta. Është e vërtetë se pa Kur’anin, pa udhëzimin e tij, pa dijen e tij dhe pa urtësinë e tij, njerëzit nuk mund të udhëzohen.

Në ajetet 41-44 Allahu i Madhëruar thotë:

¹¹ Sure "Isra", ajeti 9.

وَأَيُّهُمْ أَكَا حَمَلْنَا دُرِّيَّهُمْ فِي الْفَلَكِ الْمَشْحُونِ وَخَلَقْنَا لَهُمْ مِنْ مِثْلِهِ مَا يَرْكَبُونَ وَإِنْ نُسَا عَنْهُمْ فَلَا يَصْرِحْ لَهُمْ وَلَا هُمْ يَنْقُذُونَ إِلَّا رَحْمَةً مِنَّا وَمَتَاعًا إِلَى حِينٍ

41. Një shenjë tjetër për ata është që paraardhësit e tyre Ne i ngarkuam në anijen e mbushur plot.

42. dhe për ata Ne krijuam mjete të ngjashme me atë anije, në të cilat hipin.

43. Po të duam, Ne i fundosim ata e atëherë as nuk do të mund t'i ndihmojë kush, as nuk do të mund të shpëtojnë,

44. përveçse me mëshirën Tonë, duke i lënë ata të kënaqen njëfarë kohe.

Ajetet e mëparshme flisnin për argumentet që vërtetojnë fuqinë e Krijuesit të çdo krijese, flisnin për krijimin e diellit, të hënës, natës e ditës, për lëvizjen e tyre të përsosur në orbitat e caktuara, si dhe flisnin për krijimin e Tokës, me të gjitha begatitë që ajo përmban. Kurse ajetet në fjalë, flasin për detet dhe për një pjesë të mirësive të mëdha që vijnë prej tyre; flasin për lëvizjen e anijeve në det, qofshin tregtare apo turistike.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Allahu është Ai që e ka krijuar ujin në atë mënyrë që e lejon njeriun të lundrojë me anije mbi të. E kjo është

tregues i fuqisë së Allahut të Madhëruar e të Lartësuar. Lëvizjet e anijeve të të gjitha llojeve, tregojnë se anijet janë mjetet më të mëdha e më të rëndësishme për transport që ka në përdorim njeriu, ose tregon anijet që njeriu mund të ndërtojë në të ardhmen. Dihet se kapaciteti mbartës i anijeve është mijërafish më i madh se barra që mund të mbartin mjetet e tjera të transportit; por duhet të theksohet se energjia që i vë në lëvizje anijet, qoftë era, qoftë avulli, karburantet apo energjia atomike, të gjitha llojet e energjive, Allahu i Lartësuar i ka vënë në dispozicion të njeriut, secilën më vete, ose të gjitha së bashku, por edhe ky është një argument prej argumenteve të Allahut, që vërteton se të Gjithëfuqishmit nuk i mungon asgjë e nuk ka nevojë për asgjë.

2- Mjetet e hipjes që ecin në Tokë, det dhe ajër, mbartin njerëzit dhe sendet e tyre janë prej mirësive të Allahut.

3- Njerëzit që kanë hipur në anije, pavarësisht nga lloji e përmasat e tyre, e kuptojnë thellësinë e kuptimit të këtij ajeti, pasi edhe anija më e madhe në botë, në mesin e dallgëve të mëdha të detit dhe furisë së tufanit që shpërthen nëpër oqeanë, është si një fije kashte dhe sikur të mos ishte mëshira Gjithëpërfshirëse e Allahut, në mënyrë absolute për asnjërin prej atyre nuk do të kishte rrugë shpëtimi.

4- Asnjëherë nuk duhet të jemi të pavëmendshëm nga ndëshkimi i Allahut. Pra, nëse bëjmë vepra të këqija dhe

shohim se nuk po ndëshkohemi, kurrë mos mashtrohemi nga kjo, sepse Allahu vonon dhe nuk harron.

5- Kur zbret ndëshkimi i Allahut, nuk ka ndihmës tjetër përveç Atij.

6- Asnjëherë të mos mendojmë se pasuria e pushteti do të na mbrojnë. I pushtetshëm ishte faraoni. I pasur ishte Karuni. Por atyre nuk u bëri dobi as pushteti e as pasuria, kur zbriti dënimi i Allahut të Plotfuqishëm.

7- Për çdo njeri ka kohë të caktuar në këtë jetë. E gjithë jeta jonë është e kufizuar dhe të gjithë do të vdesim, siç thotë ajeti 185 i sures “Ali Imran”: **“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t’u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese”.**

Allahu i Madhëruar na bëftë prej besimtarëve të singertë!

Allahu na e mundësoftë që të jemi prej të shpëtuarve në Ditën e Llogarisë dhe qofshim prej atyre që shkojnë te Allahu i Madhëruar, me zemër të pastër, siç thuhet në ajetet 88-89 të sures “Esh Shuara”: **“Në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”**

AJETET 45 - 47

Në ajetin 9 të sures "Isra" thuhet:

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا كَبِيرًا

"Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh".

Kush jeton në errësirë, ëndërron për dritën. Kush jeton në humnerë, nuk i njeh majat. Kjo jetë që ne jetojmë, e cila është e mbushur me errësira, lëndime e fatkeqësi, nuk është jeta e vërtetë, sepse jeta që dëshiron Allahu të jetojmë, është më e këndshme dhe më e lartë. Jetën tonë duhet ta bazojmë mbi këshillat, porositë dhe dispozitat e Krijuesit.

Në ajetet 45-47 të sures "Jâ Sîn" thuhet:

وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ اتَّقُوا مَا بَيْنَ أَيْدِيكُمْ وَمَا خَلْفَكُمْ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ وَمَا تَأْتِيهِمْ مِنْ آيَةٍ مِنْ آيَاتِ رَبِّهِمْ إِلَّا كَانُوا عَنْهَا مُعْرِضِينَ
وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ افْعَلُوا مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ قَالِ الَّذِينَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ آمَنُوا اطَّعِمُوا مَنْ لَوْ يَشَاءُ اللَّهُ أَطْعَمَهُ إِنْ أَنْتُمْ إِلَّا فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ

45. Kur atyre u thuhet: "Druajuni asaj që keni para jush dhe asaj që është pas jush, me qëllim që Allahu t'ju mëshirojë" (ata nuk ia vënë veshin).

46. Sa herë që atyre u vjen ndonjë nga shenjat e Zotit të tyre, ata i shmangen asaj.

47. E kur atyre u thuhet: “Jepni nga ato që ju ka dhënë Allahu”, atëherë, mohuesit u thonë besimtarëve: “Pse, ne do t’i ushqejmë ata që, po të donte Allahu, do t’i ushqente Vetë? Ju jeni vërtet në humbje të qartë!”

Ajetet e mëparshme flisnin për argumentet e ndryshme të Allahut. Kurse ajetet në fjalë, flasin për kundërpërgjigjen e mohuesve, të cilët i kundërshtuan me kokëfortësi e ashpërsi të hapur argumentet e Allahut. Gjithashtu, këto ajete shpjegojnë qartë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) jo vetëm që i ftonte ata që të besonin në kumtin që ai kumtonte, por njëkohësisht edhe i paralajmëronte për dënimin e dhimbshëm të Allahut.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Njerëzit ftohen në rrugën e Zotit të tyre, duke i urdhëruar që të bëjnë punë të mira dhe duke i ndaluar nga bërja e të këqijave.

2- Frika ndaj Allahut është sekreti i fitimit të mëshirës së Allahut. Besimtarët e vërtetë i frikësohen vetëm Allahut të Madhëruar, kurse jobesimtarët i frikësohen çdo gjëje që është e fortë dhe e fuqishme mbi këtë Tokë.

Vërtet, frika ndaj Allahut, në fshehtësi dhe haptazi, është prej cilësive të besimtarëve të vërtetë. Për këtë Allahu

i Madhëruar, në Kur'an, thotë: "**...Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë**".¹² Dhe: "**Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre, që besojnë në shpalljet e Zotit të tyre, që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre, dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre**".¹³

Po të mos jetë kjo veti te njeriu, ai kurrë nuk pendohet dhe nuk nënshtrohet përpara Krijuesit të tij. Frika është shkak i lumturisë së njeriut në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër.

Frika e vërtetë duhet të jetë vetëm nga Allahu, siç thuhet në ajetin 40 të sures "El Bekare": "**...Vetëm prej Meje duhet të frikësoheni**".

Frika nga Allahu është një pemë e begatë, e cila, nëse forcohet në zemër, degët e saj do të përhapen në të gjitha gjymtyrët dhe për çdo kohë do ta japë frutën e saj, me lejen e Zotit të saj dhe ky fryt është vepra e mirë, fjala e mirë dhe sjellja e mirë.

Frika nga Allahu nuk të lë të bësh gjynahe dhe gabime. Ajo të zgjon ndërgjegjen, të zbut zemrën dhe të mbron nga egoja.

¹² Sure "Ali Imran", ajeti 175.

¹³ Sure "El Mu'minun", ajetet 57- 60.

Frika nga Allahut është ajo që i nxit njerëzit për çiltërsi në veprat e tyre. Janë vepra që nuk kërkojnë asnjë shpërblim nga njerëzit, por vetëm nga Allahu.

Frika nga Allahu është dashuri për Allahun. Frika nga Allahu është njohje e Allahut. Sa më shumë të shtohet njohja e Allahut te njeriu, aq më shumë afrohet ai tek Allahu dhe aq më shumë njihet ai me cilësitë e Allahut.

3- Për të vërtetuar diçka, duhet të paraqiten disa argumente logjike.

4- Argumentet e Allahut janë të shumta në këtë ekzistencë, por, fatkeqësisht, të paktë janë ata që i besojnë ato. Në ajetin 46 prej ajeteve në fjalë, thuhet: **“Sa herë që atyre u vjen ndonjë nga shenjat e Zotit të tyre, ata i shmangen asaj”**.

5- Te mohuesit nuk ndikojnë as argumentet shpirtërore, as argumentet që shihen në botën e jashtme, as kërcënimi, as paralajmërimi dhe as përgëzimi për mëshirën hyjnore. Mohuesit nuk e pranojnë mendimin logjik, nuk pranojnë as çështjen e ndjenjave, nuk pranojnë as natyrën e pastër të krijimit. Me kundërshtimin e tyre, mohuesit e kanë vënë veten në sprovë me një verbëri të plotë, madje aq e madhe është verbëria e tyre, sa nuk kanë mundësi të shohin as sendet që kanë afër vetes dhe nga kjo verbëri mohuesit nuk bëjnë dot dallim as në mes errësirës së natës dhe Diellit të mesditës.

6- Kokëfortësia e njeriut arrin deri në atë masë, saqë ai i shpërfill argumentet, nuk e dëgjon këshillën.

7- Ai që nuk zotëron një vizion të drejtë dhe nuk dëshiron të mbajë përgjegjësi, do të përballet me devijimin dhe me veprat e këqija.

8- Duhet ta dimë se gjithçka që kemi, është nga Allahu i Plotfuqishëm e Bujar. Prandaj që duhet të japim nga ajo që na është dhënë.

9- Mosbesimi është shkak i mosdhënies, siç thotë ajeti 47 prej ajeteve në fjalë: **"...mohuesit u thonë besimtarëve: "Pse, ne do t'i ushqejmë ata që, po të donte Allahu, do t'i ushqente Vetë?"**

10- Dhënia është shenjë e besimit.

11- Njeriu arrin deri aty, saqë mendon se mosbesimi dhe koprracia janë e drejtë, kurse besimi dhe shpenzimi është i gabuar.

AJETET 48 - 50

Në ajetin 155 të sures “El En’am”, Allahu i Madhëruat thotë:

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni”.

Kur’ani është përsosmëria e vërtetë. Cilido që e mëson Kur’anin dhe e kristalizon atë në brendinë e tij, sigurisht që mbart një mirësi të madhe dhe pasuri të pashtershme. Kur’ani është tryeza e Allahut për njerëzit. Ai e ka zbukuruar këtë tryezë me llojet më të përsosura e të panumërta të ushqimeve, për dijen dhe shpirtin. Në këtë tryezë gjendet çdo gjë, për të cilën kanë nevojë njerëzit.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Sigurisht, ky Kur’an është tryeza e Allahut, prandaj, studiojeni sa të mundeni tryezën e Tij”.

Kur’ani është depozita e dijeve të Allahut. Ai që ndriçohet me këtë dije dhe i mbart ato, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i*

Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Mbartësit e Kur'anit janë të diturit e banorëve të Xhenetit".

Në vazhdim të paraqitjes së mësimeve që përmbajnë ajetet e sures "Jâ Sîn", zemra e Kur'anit, do të analizojmë ajetet 48-50 të saj. Në këto ajete, Allahu i Gjithëdijsëm e Fuqplotë thotë:

وَيَقُولُونَ مَتَى هَذَا الْوَعْدُ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ مَا يَنْظُرُونَ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً تَأْخُذُهُمْ وَهُمْ يَخِصِّمُونَ فَلَا يَسْتَطِيعُونَ تَوْصِيَةً وَلَا إِلَىٰ أَهْلِهِمْ يَرْجِعُونَ

48. Ata (jobesimtarët) thonë: "Kur do të përmbushet ky premtim (i ringjalljes), nëse ajo që thoni është e vërtetë?"

49. Ata presin vetëm një zë të tmerrshëm, që do t'i kaplojë, ndërsa grinden me njëri-tjetrin.

50. Atëherë ata nuk do të mund të lënë testament e as të kthehen te familjet e tyre.

Në ajetet e mëparshme u përmend logjika e zbrazët dhe pretekstet e sajua që nxirrnin mohuesit, në lidhje me çështjen e shpenzimit. Ndërsa ajetet në fjalë, pra, ajetet 48-50, flasin se si talleshin mohuesit me Ditën e Kiametit, kur, me logjikën e tyre të gabuar e të pabazuar në argumente, përgjigjeshin në formë të prerë, duke mohuar ringjalljen pas vdekjes.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Jobesimtarët nuk kanë asnjë argument që mohon Ringjalljen. Për këtë, ata mjaftohen me pyetjen, në formë tallëse, se kur do të ndodhë Ringjallja.

2- Moscaktimi i kohës së ndodhisë së diçkaje nuk do të thotë se nuk do të ndodhë. Askush nga ne nuk e di kohën e vdekjes, mirëpo shohim se vdekja nuk ndalon. Asnjë njeri nuk e di kohën e ndodhisë së tërmetit, mirëpo ai ndodh.

3- Ringjallja është premtim i Allahut dhe Allahu kurrë nuk e thyen premtimin e Tij. Në ajetin 6 të sures “Er Rrum” thuhet:

وَعَدَ اللَّهُ لَا يَخْلِفُ اللَّهُ وَعْدَهُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

“(Ky është) **premtimi i Allahut, e Allahu nuk e thyen premtimin e vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë**”.

4- Jobesimtarët i konsiderojnë gënjeshtarë profetët dhe besimtarët, siç kuptohet në thënien e ajetit 48, prej ajeteve që po flasim: “...nëse ajo që thoni është e vërtetë”.

5- Ndodhia e Kiametit do të jetë e papritur, prandaj nuk duhet të tallemi e nuk duhet të jemi të pavëmendshëm.

6- Kur të bëhet Kiameti, gjuhët do të heshtin dhe do të mbyllen dyert e ikjes. Askush nuk do të flasë e askush nuk ikën. Në ajetin e 50 të ajeteve në fjalë, thuhet: “**Atëherë ata**

nuk do të mund të lënë testament e as të kthehen te familjet e tyre".

7- Kiameti do të ndodhë vetëm nga një zë i tmerrshëm: **"Ata presin vetëm një zë të tmerrshëm".**

8- Kur të bëhet Kiameti, mbaron kjo jetë. Të gjithë do të dalim para Krijuesit Fuqiplotë. Lum ata që kanë bërë mirë në këtë jetë! Atyre do t'u jepet libri i veprave nga e djathta e tyre dhe llogaridhënia e tyre do të jetë e lehtë.

9- Kur të bëhet Kiameti, nuk do të na bëjnë dobi as lidhjet, as marrëdhëniet në këtë dynja e as kujdesi me zemër ndaj dynjasë. Të gjitha këto do të zhduken, kur të bëhet Kiameti. Ajo që do mbetet dhe do të na shoqërojë, është puna jonë.

Në ajetin 33 të sures "Lukman" thuhet:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمْ وَأَخْشَوْا يَوْمًا لَا يَجْزِي وَالِدٌ عَنْ وَلَدِهِ وَلَا مَوْلُودٌ هُوَ جَارٌ عَنْ وَالِدِهِ شَيْئًا ۚ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُم بِاللَّهِ الْغُرُورُ

"O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t'ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t'ju mashtrojë për Allahun".

Të dashur vëllezër dhe motra! Allahu i Madhëruar nuk e dënon atë njeri që e mëson, e mbart dhe e zbaton

Kur'anin, sepse një njeri i tillë është bërë Kur'an lëvizës në çdo hap që hedh në jetë dhe Kur'ani është bërë mbrojtësi i tij. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Lexojeni Kur'anin dhe shfaqeni atë (në vepra e në fjalë), sepse Allahu nuk e dënon atë zemër që mbart Kur'anin”*.¹⁴

Allahu na e ndriçoftë mendjen, zemrën dhe jetën me dritën e Kur'anit!

¹⁴ “Uesailu shi'ia”, vëll. 4, f. 245.

AJETET 51 - 54

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mësojeni Kur’anin, sepse ai është pranvera e zemrave. Kërkoni shërim me dritën e tij, sepse ai është shërues i kraharorëve”.

Kur’ani i shenjtë është drita udhëzuese e Allahut dhe shpëtuesi nga humbja dhe devijimi. Kur’ani është dritë që shkatërron dhe zhduk errësirat që mbulojnë zemrën. Ai ndriçon ndjenjat dhe hap horizontet e të menduarit. Kur’ani rrethon shpirtin, duke e rifreskuar dhe duke e ringjallur atë. Ai na ndriçon rrugët e lëvizjeve tona.

Kur’ani është i qartë dhe i lehtë për t’u kuptuar. Përmbajtja e tij është prej Allahut. Kjo përmbajtje ka si qëllim nxjerrjen e njeriut prej rrethit të pavetëdijes, në lulishten e vetëdijes, të kujtesës dhe të zgjimit.

وَنُفِّخْ فِي الصُّورِ فَإِذَا هُمْ مِنَ الْأَجْدَاثِ إِلَىٰ رَبِّهِمْ يَنْسِلُونَ قَالُوا يَا وَيْلَنَا مَن بَعَثَنَا مِن مَّرْثَدِنَا هَذَا مَا وَعَدَ الرَّحْمَنُ وَصَدَقَ الْمُرْسَلُونَ إِنْ كَانَتْ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً فَإِذَا هُمْ جَمِيعٌ لَّدَيْنَا مُحْضَرُونَ فَالْيَوْمَ لَا تُظْلَمُ نَفْسٌ شَيْئًا وَلَا تُجْزَوْنَ إِلَّا مَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

51. Dhe, kur të fryhet në Sur, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre,

52. duke thënë: “Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?” (Do t’u thuhet): “Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të dërguarit kanë thënë të vërtetën!”

53. Do të jetë ai vetëm një zë i tmerrshëm e ata të gjithë do të paraqiten para Nesh.

54. Atë ditë askujt nuk do t’i bëhet ndonjë padrejtësi dhe ju do të shpërbleheni vetëm sipas asaj që keni bërë.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Kur’ani i shenjtë përmend dy fryrje të surit. Fryrja e surit që përmendet në ajetin 51 prej ajeteve në fjalë, është ajo e Ringjalljes. Pikërisht, më zërin e fryrjes së surit do të fillojë Kiameti. Patjetër që Dita e Kiametit është një ndodhi tmerruese. Nga tmerri i ndodhive të Ditës së Kiametit njeriu trulloset deri në atë shkallë, sa i harron të gjitha mitet dhe gjërat e gabuara, në të cilat ka besuar. Në atë Ditë, për njeriun s’ka asnjë mundësi, veçse të pohojë të vërtetat, qartë e saktë.

Ajeti i nderuar i përshkruan varret si vende fjetjeje dhe ngritjen prej varreve, domethënë Ringjalljen, e përshkruan si ngjarje që do të ndodhë menjëherë pas “fryrjes”, ashtu siç e lexojmë në hadithin mjaft të përhapur:

"Ashtu siç flini, do të vdisni dhe ashtu siç zgjoheni prej gjumit, do të ringjallen".

2- Ringjallja do të jetë me trup dhe të gjithë trupat do të dalin nga varri: **"ata do të dalin nga varret"**. Kockat e shkërmoqura, të bëra pluhur, riveshin rrobën e jetës, të gjithë njerëzit ngrihen prej varreve me formën njerëzore të plotë, që të jenë të pranishëm për të dhënë llogari në atë gjykatë frikësuese. Ashtu siç vdiqën të gjithë vetëm nga një britmë e vetme, po ashtu do të ringjallen prej një britme të vetme. Vdekja e shpërbërja e trupave të tyre nuk janë pengesë para fuqisë së Allahut të Lartësuar për të ringjallur njerëzit. Grumbullimi i njerëzve në Ditën e Kiametit është i ngjashëm me grumbullimin e një njësie ushtarake, me anë të rënies së një borie dhe të gjithë ushtarët ngrihen prej shtretërve ku janë shtrirë në gjumë. Vetëm me një të rënë borie, forcat ushtarake rreshtohen në formacionet përkatëse. Po, kaq e thjeshtë, por shumë e shumë më e shpejtë, do të jetë edhe ringjallja e njerëzve në Ditën e Kiametit, në raport me fuqinë e Allahut të Lartësuar.

3- Ringjallja e njerëzve do të jetë shumë e shpejtë dhe e lehtë.

4- Lëvizja e shpejtë e njerëzve në Ditën e Kiametit është shenjë e hutisë dhe e shqetësimit të.

5- Dita e Kiametit është ditë mjerimi për jobesimtarët.

6- Vendi i Kiametit është i gjerë dhe aty njerëzit do të pohojnë dhe do të dëshmojnë për vërtetësinë e Ringjalljes.

7- Në Ditën e Kiametit, njerëzit do të tubohen në një vend të përbashkët: **“e ata të gjithë do të paraqiten para Nesh”**.

8- Prania në Ditën e Kiametit nuk është çështje zgjedhëse.

9- Allahu është i Drejtë. Dita e Kiametit është dita në të cilën do të shpaloiset drejtësia e Allahut: **“Atë ditë askujt nuk do t’i bëhet ndonjë padrejtësi”**.

10- Shpërblimi dhe ndëshkimi në Ditën e Kiametit bazohen te punët e njeriut në këtë jetë: **“dhe ju do të shpërbleheni vetëm sipas asaj që keni bërë”**.

Gjuha që është përdorur në këto ajete, lë gjurmë të thella në zemrat e njerëzve dhe është sikur ajo britmë thotë: “O njerëz, o ju kokrriza dheu të shpërndara, o ju kocka të bëra pluhur! Ngrihuni, ngrihuni dhe përgatituni për të dhënë llogari e për të marrë atë që keni merituar me punën tuaj!”

Sa fjalë të bukura janë këto shprehje kur’anore dhe sa domethënëse janë paralajmërimet që shprehin fjalët e ajetit!

Prandaj, të dashur vëllezër dhe motra, duhet të besojmë dhe të bëjmë punë të mira për atë Ditë, kur të gjithë ne do të dalim para Allahut të Madhëruar, siç thotë Allahu

Fuqiplotë: "Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve".¹⁵

Punoni se punët tuaja do të shihen. Allahu i Madhëruar na thotë: **"Thuaj: "Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë"**".¹⁶

¹⁵ Sure "El Mutaifin", ajeti 6.

¹⁶ Sure "Et Teube", ajeti 105.

AJETET 55 - 58

لِأَصْحَابِ الْجَنَّةِ الْيَوْمَ فِي شُغْلٍ فَاعْمَلُوا هُمْ وَأَزْوَاجُهُمْ فِي ظِلَالٍ عَلَى الْأَرَائِكِ مُتَكِدِّينَ لَهُمْ فِيهَا فَاكِهَةٌ وَلَهُمْ مَا يَدْعُونَ سَلَامٌ قَوْلًا مِنْ رَبِّ رَحِيمٍ

55. Sigurisht që atë ditë banorët e Xhenetit nuk do të mendojnë për gjë tjetër, veç lumturisë së tyre.

56. Ata dhe gratë e tyre do të jenë në hije, të mbështetur në ndenjësë të lartuara.

57. Për ata do të ketë aty fruta dhe çdo gjë që dëshirojnë.

58. “Paqe!” do të jetë fjala prej Zotit Mëshirëplotë.

Në ajetin 31 të sures “El Fatir”, thuhet:

وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ هُوَ الْحَقُّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ إِنَّ اللَّهَ بِعِبَادِهِ لَخَبِيرٌ بَصِيرٌ

“Ajo që ta kemi shpallur ty në Libër, është e vërteta, e cila miraton atë që është shpallur para tij. Sigurisht që Allahu i njeh dhe i sheh mirë robërit e Vet”.

Kur’ani është e vërteta dhe vërteton ato që janë shpallur para tij.

Kur'ani është përgëzues për myslimanët dhe për besimtarët. Allahu ua ka premtuar atyre shpërblimin prej shpërblimit të madh dhe begatisë së përhershme. **"...dhe përgëzues për myslimanët..."**¹⁷

Siç shihet, nga përmbajtja, këto ajete flasin për banorët e Xhenetit. Në Kur'anin e shenjtë Xheneti përmendet 66 herë dhe bashkë me fjalët që formohen prej së njëjtës rrënjë, përmendet 147 herë. Të gjitha fetë e pranojnë ekzistencën e Xhenetit (Parajsës).

Nga këto ajete mësojmë

1- Banorët e Xhenetit mahniten me pamjen e bukurive e të mirësive të Xhenetit, të cilat as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar e as në mendje nuk janë përfytyruar.

2- Në Xhenet nuk ka mërzitje, hidhërim, brengë, shqetësim, stres e depresion. Aty ka vetëm e vetëm lumturi.

3- Në Xhenet ka jetë pa vdekje, shëndet pa sëmundje, rini pa pleqëri, krenari pa poshtërim, mirësi pa sprovë, qëndrimi në të do të jetë i përjetshëm, ka gëzim pa zemërim.

4- Në Xhenet nuk ka vetmi: **"Ata dhe gratë e tyre"**.

¹⁷ Sure "En Nahl", ajeti 89.

5- Në Xhenet ka qetësi dhe banorët e tij do të qëndrojnë të mbështetur në ndenjësë të larta e të rehatshme.

6- Në Xhenet gjendet ushqimi më i mirë e frutat më të mira. Fjala “*fakiheten*” është në trajtën e pashquar, e cila tregon bollëkun e këtyre frutave. Banorët e Xhenetit do të kënaqen me mirësitë që Allahu u ka përgatitur, të cilat janë të pashoqe për nga pamja dhe nga shija. Xheneti është vendbanim i përhershëm dhe begatitë e tij janë të pandërprera. Aty do të banojnë punëmirët.

7- Çdo gjë në Xhenet është e pakufizuar, siç thotë ajeti 57: **“Për ata do të ketë aty fruta dhe çdo gjë që dëshirojnë”**.

8- Ringjallja do të jetë me trup dhe këtë e tregojnë fjalët: bashkëshorte, fruta, ushqime që përmenden në këto ajete.

9- Banorët e Xhenetit përshëndeten nga Allahu: **“Paqe!” do të jetë fjala prej Zotit Mëshirëplotë**”. Gjithashtu, Allahu do të jetë i kënaqur me ata. Në ajete të tjera të Kur’anit lexojmë se engjëjt i përshëndesin banorët e Xhenetit, siç thuhet në ajetet 23-24 të sures “Er Rra’ad”: **“...Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e Xhenetit e do t’u thonë): “Paqja qoftë mbi ju!...”**

Po ashtu, përshëndetja e banorëve të Xhenetit do të jetë “Selam”-“Paqe”, siç thuhet në ajetin 10 të sures “Junus”: **“... Përshëndetja e tyre do të jetë “Selam”...”**

10- Xheneti fitohet:

- duke besuar dhe duke bërë punë të mirë;
- duke iu bindur Allahut dhe të Dërguarit të Tij;
- duke vepruar me sinqeritet;
- duke qenë i devotshëm;
- duke përmendur Allahun dhe duke menduar rreth krijimit;
- duke pasur frikë nga Allahu;
- duke kërkuar falje për gjynahet;
- duke urdhëruar në të mirë, duke ndaluar nga e keqja, duke falur namazin dhe duke dhënë zekatin;
- duke luftuar e duke u përpjekur në Rrugën e Allahut, me pasuri e me shpirt;
- duke qenë i palëkundshëm në Rrugën e Allahut (Istikame);
- duke mbartur moral të mirë, duke u kujdesur për nevojtarët, të varfrit dhe jetimët, duke u sjellë mirë me prindërit, me fqinjët dhe me njerëzit;
- duke ndërtuar xhami, institucione dobiprurëse për shoqërinë;

• duke agjëruar, duke bërë Haxhin dhe vepra të tjera të mira.

Të dashur vëllezër dhe motra!

Qëllimi ynë më i lartë në këtë jetë le të jetë sigurimi i Xhenetit në Jetën Tjetër. Në Xhenet është lumturia e vërtetë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e shenjtë: **“Kurse fatlumët, do të hyjnë në Xhenet, ku do të qëndrojnë përherë, derisa të jenë qiejt dhe Toka, veç si të dojë Zoti yt. Kjo është dhuratë e pandërprerë”**.¹⁸

Allahu na bëftë prej banorëve të Xhenetit!

¹⁸ Sure “Hud”, ajeti 108.

AJETET 59 - 64

Në ajetin 82 të sures "Isra", Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë:

وَنَزَّلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ۚ وَلَا يَزِيدُ الظَّالِمِينَ إِلَّا خَسَارًا

"Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje".

Libri i Allahut, Kur'ani i shenjtë, është libër i njohjes, i moralit, i udhëzimit, i lumturisë dhe i përsosmërisë. Ai është i pandryshuar dhe i tillë do të vazhdojë deri në fund të kësaj jete.

Islami dhe Kur'ani kanë ardhur për të ndërtuar njeriun e vërtetë dhe për edukimin e drejtë të tij. Qëllimi i zbritjes së këtij Libri të shenjtë është që prej tij të përfitojnë të gjithë njerëzit, sipas mundësive të tyre. Por është për të ardhur keq se as ne, as njerëzimi dhe as dijetarët myslimanë nuk kanë përfituar ashtu siç duhet nga ky Libër i shenjtë.

Ata që duan ta kuptojnë ashtu siç duhet Kur'anin dhe përmbajtjen e tij, sa herë që e lexojnë, duhet të largojnë pengesat që gjenden në brendinë e tyre, me qëllim që të shohin dritën e vërtetë të këtij Libri të shenjtë.

Ata që qëndrojnë pas pengesave të shumta, nuk e kuptojnë dritën dhe hamendësojnë se mund ta perceptojnë atë, mirëpo ata janë të paafte ta perceptojnë dritën e vërtetë.

Kthimi te Kur'ani është kthim në jetën që i përshtatet njeriut. Nëse kthimi te Kur'ani bëhet me bindje të plotë, do të dallohej shumë qartë e vërteta nga e pavërteta dhe i gjithë njerëzimi do të ecte në rrugën e lumturisë, si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër.

Pak më poshtë, do të paraqesim mësimet që transmetojnë ajetet 59-64 të sures “Jâ Sîn”. Në këto ajete, Allahu thotë:

امْتَاوَا الْيَوْمَ أَيُّهَا الْمُنْجِرُونَ أَلَمْ أَعْهَدْ إِلَيْكُمْ يَا بَنِي آدَمَ أَنْ لَا تَعْبُدُوا الشَّيْطَانَ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ وَأَنْ اعْبُدُونِي هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ وَلَقَدْ أَضَلَّ مِنْكُمْ جِبِلًّا كَثِيرًا أَفَلَمْ تَكُونُوا تَعْقِلُونَ هَذِهِ جَهَنَّمُ الَّتِي كُنْتُمْ تُوعَدُونَ اضْلُوهَا الْيَوْمَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ

59. Sot ju o kriminelë ndahuni (prej besimtarëve).

60. A nuk ju porosita o bij të Ademit të mos adhuronit djallin; me të vërtetë ai për ju është armik i hapur.

61. të më adhuronit Mua, ja kjo është Rruga e drejtë.

62. Në të vërtetë, ai (djalli) ka futur në rrugën e humbjes shumë prej jush; a nuk po mendoni?”

63. Ky është Xhehenemi që ju është premtuar.

64. Sot hyni në atë (Xhehenem) për shkak të mohimit tuaj.

Në ajetet e mëparshme, mësuam një anë të së ardhmes së gëzuar të banorëve të Xhenetit, kurse në ajetet në fjalë do të shikojmë anën e mjeruar të së ardhmes së banorëve të zjarrit dhe të adhuresve të djallit.

Ky realitet që përmendet në këto ajete, është realizimi i premtimit të Allahut, i ardhur në ajetin 28 të sures "Sàd": **"A mos do t'i barazojmë ata që besuan dhe bënë punë të mira me ata që bëjnë shkatërime në Tokë, apo të konsiderojmë të ruajturit si ata që janë mëkatarë?"**.

Nga këto ajete mësojmë

1- Dita e Kiametit është Dita e ndarjes, siç thotë ajeti 59 i ajeteve në fjalë: **"Sot ju o kriminelë ndahuni (prej besimtarëve)"**.

2- Allahu i ka porositur bijtë e Ademit nëpërmjet profetëve (ajeti 60): **"A nuk ju porosita o bij të Ademit..."**

3- Shejtani është armiku i përбетuar i njeriut. Ai i mashtroi të parët, ju mashton juve dhe do të mashtrojë edhe ata që do të vijnë, me përjashtim të besimtarëve të devotshëm. Prandaj duhet ta marrim armik atë dhe jo mik. Fatkeqësisht ka shumë njerëz që e adhurojnë shejtanin, duke iu bindur atij. Në ajetin 60, prej ajeteve në fjalë, Allahu na

thotë: **“të mos adhuronit djallin; me të vërtetë ai për ju është armik i hapur”.**

4- Njeriu është në mes të dy adhurimeve: ose është adhurues i Allahut, ose adhurues i shejtanit. Për këtë Allahu na thotë: **“...mos adhuronit djallin... më adhuronit Mua...”**

5- Duke iu bindur shejtanit, njeriu arriti të marrë për zot gurë e dru e njerëz dhe besonin në këta idhuj. Pa dyshim që ndjekja e shejtanit çon në humbje të madhe.

6- Rruga e drejtë, për të cilën ne i lutemi Allahut, ditë e natë, që të na udhëzojë e të na forcojë në të, është rruga e adhurimit të Tij. Për këtë, në ajetin 61 të ajeteve në fjalë, Allahu thotë: **“Dhe të më adhuronit Mua, ja kjo është Rruga e Drejtë”.**

7- Të nxjerrim mësim nga fundi i hidhur e i dhembshëm i të humburve e i të devijuarve të mëparshëm dhe t’i lutemi Allahut, që të na udhëzojë në rrugën e drejtë dhe të kemi një fund të kënaqur.

8- Të menduarit rreth fundit të atyre që shejtani i çoi në humbje, i hap njeriut rrugën e shpëtimit nga cytjet dhe mashtrimet e tij. Në ajetin e 62, prej ajeteve në fjalë, thuhet: **“Në të vërtetë, ai (djalli) ka futur në rrugën e humbjes shumë prej jush; a nuk po mendoni?”**

9- Në Kur’an, Allahu e përsërit shumë hyrjen e mohuesve në zjarr, mirëpo mohuesit nuk e besojnë dhe nuk

binden. Në ajetin 63 prej ajeteve në fjalë Allahu thotë: **“Ky është Xhehenemi që ju është premtuar”**.

10- Allahu e ka plotësuar argumentin ndaj banorëve të Xhehenemit dhe vazhdimi i lajmëron për rrezikun e zjarrit të Xhehenemit. Ai na paralajmëron, që të mos bëjmë vepra të këqija, sepse fundi i veprave të këqija është Zjarri i Xhehenemit, në të cilin njerëzit do të hyjnë për shkak të punëve të tyre të këqija në këtë jetë. Allahu nuk i bën padrejtësi askujt.

11- Mohuesit do të hyjnë në zjarr të poshtëruar. Ata kurë nuk do të dalin prej tij.

Allahu na bëftë prej atyre që e kuptojnë Kur'anin dhe e zbatojnë atë në jetën e tyre! Allahu na e ndriçoftë jetën me dritën e Kur'anit!

AJETI 65

Në ajetin 24 të sures “Muhamed”, Allahu i Madhëruar thotë:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْفُرْعَانُ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا

“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur’anin apo i kanë zemrat të kyçura?!”

Kur’ani, libri i fundit i Allahut, përmban programin më të plotë dhe më të përkryer të jetës për njeriun. Kur’ani është i vetmi libër që i siguron njeriut lumturinë e vërtetë në të dyja jetët. Kur’ani është drita e përhershme; është anija e shpëtimit në mesin e dallgëve të fuqishme të jetës.

Përmbajtja e Kur’anit është aq mahnitëse dhe aq madhështore, sa që i ka detyruar mendimtarët dhe dijetarët e shumë jomyslimanë ta pranojnë madhësinë e tij.

Kur’ani i shenjtë është kushtetuta e përsosur e jetës. Ai është mrekullia e përhershme, që Allahu ia shpalli Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Allahu e ka zbritur Kur’anin për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kohët. Kjo e vërtetë e padiskutueshme është prej mrekullive të Kur’anit. Ai u flet të gjithë njerëzve, pa dallim mendësie, ideologjie, kombi, race, ngjyre, gjuhe, vendi e kohe. Prandaj të gjithë njerëzit duhet ta hedhin

vështrimin e tyre kah Kur'ani, ta lexojnë, ta studiojnë, të përsiatin ajetet e tij dhe ta marrin Kur'anin prijës në jetën e tyre.

Në ajetin 65 të sures "Jâ Sîn" thuhet:

النُّومُ نَحْنُمُ عَلَىٰ أَفْوَاهِهِمْ وَتَكَلَّمْنَا بِأَنفُسِهِمْ وَتَشْهَدُ أَرْجُلُهُمْ بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ

"Sot Ne do t'ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë".

Nga ky ajet mësojmë:

1- Dita e Kiametit është Dita në të cilën heshtin gojët dhe dëshmojnë gjymtyrët.

2- Dëshmitarët që do të dëshmojnë kundër njerëzve, në Ditën e Kiametit do të jenë gjymtyrët e trupit të tyre, prandaj nuk mbetet më vend që ata të mohojnë dëshminë e atyre dëshmitarëve. Për këtë, Allahu i Lartësuar njofton: **"Sot Ne i mbyllim gojët e tyre dhe do të flasin duart e tyre e do të dëshmojnë këmbët e tyre, për punët që ata kanë bërë".**

3- Allahu është Ai që bën të flasë e të heshtë. Gojët, që janë mjeti i komunikimit, Allahu do t'i heshti ato në Ditën e Ringjalljes dhe do t'i bëjë duart dhe këmbët të flasin. Prandaj duhet të kemi kujdes dhe të ruajmë gjuhën dhe

gjymtyrët. Në ajetin 36 të sures “Isra” thuhet: **“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi”**.

Madje edhe lëkura do të dëshmojë në Ditën e Kiametit, siç thuhet në ajetin 20 të sures “Sexhde”: **“Ata do t’u thonë lëkurëve të veta: ‘Pse dëshmuat kundër nesh?’ e ato do të përgjigjen: ‘Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni’”**.

4- Ringjallja do të jetë me trup. Këtë e dëshmon thënia e ajetit: **“...do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre...”**

5- Atë Ditë gjymtyrët e trupit të njeriut nuk do t’i binden vullnetit e prirjeve të tij; të gjitha gjymtyrët në atë Ditë nuk do të pranojnë urdhrat e tij, por do të dorëzohen para urdhrit të Allahut. Sa e habitshme është gjykata e Ditës së Kiametit! Në atë gjykatë, dëshmitarët do të jenë vetë gjymtyrët e trupit të njeriut, ato gjymtyrë me të cilat ai mëkatoi e bëri faje. Në ajetin 24 të sures “En Nûr”, lexojmë fjalën e të Lartit: **“Atë Ditë do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre, për punët që ata kanë bërë”**.

6- E folura e gjymtyrëve do të jetë e veçantë vetëm për mohuesit kriminelë, pasi llogaridhënia për besimtarët është e qartë, ashtu siç e lexojmë në një transmetim të ardhur

prej Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*): *"Gjymtyrët nuk dëshmojnë kundër besimtarit, gjymtyrët do të dëshmojnë vetëm kundër atyre që e kanë merituar dënimin; besimtarit do t'i jepet libri i punëve të tij në dorën e djathtë"*. Pikërisht, për këtë ngjarje njofton Allahu i Lartësuar në ajetin 7 të sures "El Isrà": **"Atij që i jepet libri i tij në dorën e djathtë, ata e lexojnë librin e tyre dhe atyre nuk u bëhet as padrejtësia më e vogël"**.

7- Gjymtyrët e trupit të njeriut ruajnë gjurmët e punëve që ai ka bërë në këtë botë. Asnjë punë e bërë në këtë botë nuk zhduket, gjurmët e asaj pune do të mbeten në çdo gjymtyrë të trupit e në mjedisin rrethues dhe në atë Ditë, dalja sheshit e gjurmëve të atyre punëve është në pozitën e dëshmisë.

8- Allahu i Lartësuar, çdo gjymtyrë i jep fuqinë të flasë e të ketë ndjenja dhe gjymtyrët do të pohojnë të vërtetën me singëritet. A mund të ketë gjë më të çuditshme se kjo? Allahu i Lartësuar, në një copë mishi të quajtur "gjuhë" dhe në "trurin e njeriut", ka krijuar mundësinë që njerëzit të flasin, patjetër që Ai ka mundësi që këtë fuqi ta bëjë për të gjitha gjymtyrët e trupit të njeriut.

9- Dëshmia e gjymtyrëve për çdo gjë shkakton çudinë më të madhe te mohuesit kriminelë, të cilët në atë Ditë do të shohin se të gjitha rrugët për t'u larguar e për të shpëtuar, janë të bllokuara për ta.

Të dashur vëllezër dhe motra! Në ajetin 33 të sures “Lukman”, Allahu i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ وَأَحْسِنُوا يَوْمًا لَا يَنْجِي وَالِدٌ عَنْ وَلَدِهِ وَلَا مَوْلُودٌ هُوَ جَارٌ عَنْ وَالِدِهِ شَيْئًا إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّكُمْ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّكُمْ بِاللَّهِ الْغُرُورُ

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t’ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun”.

Ky ajet dëshmon qartë atë që thamë në fillim, që Kur’ani ka zbritur për të gjithë njerëzit.

AJETET 66 - 68

Në ajetet 66-68 të sures "Jâ Sîn" thuhet:

وَلَوْ نَشَاءُ لَطَمَسْنَا عَلَى أَعْيُنِهِمْ فَاسْتَبَقُوا الصِّرَاطَ فَأَنَّى يُبْصِرُونَ
وَلَوْ نَشَاءُ لَمَسَخْنَاهُمْ عَلَى مَكَاتِبِهِمْ فَمَا اسْتَعَاثُوا مُضِيًّا وَلَا يُرْجِعُونَ
وَمَنْ نُعِزُّهُ نُكَذِّبْهُ فِي الْخَلْقِ أَفَلَا يَعْقِلُونَ

66. Sikur të donim, Ne do t'ua verbonim atyre sytë, kështu që ata do ta kërkonin më kot rrugën! Vallë, si do të shihnin?

67. Sikur të kishim dashur, Ne do t'i kishim shndërruar ata (në krijesa të tjera) në atë vend e ata nuk do të mund as të shkonin e as të ktheheshin.

68. Kujtdo, që i japim jetë të gjatë, Ne e bëjmë sërish krijesë të dobët. Vallë, a nuk kuptojnë ata?

Para se të themi se çfarë mësojmë nga këto ajete, le të hedhim një sy në disa ajete të tjera të Kur'anit famëlartë, që trajtojnë çështjen e përfitimit nga leximi i këtij Libri të shenjtë.

Në ajetin 8 të sures "Et Tegabun" thuhet:

قَامُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَالْثَوْرِ الَّذِي أَنْزَلْنَا وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ

“Prandaj besoni në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në dritën (Kuranin), që ju kemi zbritur. Allahu e di mirë çdo gjë që bëni ju”.

Kur’ani është shpirt dhe trup. Shpirti i tij është udhëzimi dhe drita, kurse trupi i tij janë fletët dhe fjalët e tij të shkruara. Trupi i Kur’anit arrihet lehtë nga të gjithë, qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Shpirtit i Kur’anit - drita e udhëzimi tij - nuk arrihet lehtë. Që të arrijë shpirtin e Kur’anit, njeriu duhet të ketë shpirt të pastër.

Njeriu ka nevojë për ndriçim për të zbuluar të vërtetat. Allahu i Madhëruar e cilëson Librin e Tij dritë dhe Libër i qartë. Kjo dritë është e dobishme vetëm për atë që ka arsyetim. Kur’anin e kuptojnë të zotët e mendjes. Nëse njeriu nuk ka mendje të shëndoshë e vëmendje të ngulët, ai është i pa aftë për ta kuptuar Kur’anin dhe përmbajtjen e tij të thellë e të pashtershme.

Në Kur’an çdo gjë është e qartë. Ai sqaron të vërtetat dhe zbulon çështjet e jetës dhe rregullat e saj të përgjithshme. Allahu i Plotfuqishëm, nëpërmjet Kur’anit, udhëzon në atë që është më e mira. Por, kush është i aftë ta rrokë këtë udhëzim? Në ajetin që u citua më lart, thuhet se të aftët për udhëzim janë: **“...ata që ndjekin pëlqimin e Tij...”**¹⁹

¹⁹ Sure “El Maide”, ajeti 16.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Ajeti 66 tregon për njërin prej llojeve të dënimeve, me të cilat Allahu i Lartësuar do të vërë në sprovë kriminelët mohues në këtë botë. Ajeti i nderuar njofton: **"Sikur Ne të duam, atyre ua verbojmë sytë"**. Në një gjendje të këtillë, tmerri tek ata arrin kulmin, ashtu siç njofton ajeti: **"...kështu që ata do ta kërkonin më kot rrugën!"**. Në këtë gjendje, ata nuk kanë mundësi të gjejnë as rrugën për të shkuar nëpër shtëpitë e veta, s'kanë mundësi të gjejnë drejtimin që i çon te Rrugë e Vërtetë apo që ata të ecin në Rrugën e Drejtë! Por Allahu është i Mëshirshëm dhe u jep mundësi njerëzve që ata të kthehen te Ai.

2- Asnjëherë të mos mendojmë se ajo që kemi, do të qëndrojë përgjithmonë. Çdo gjë do të zhduket. Mos të na bëjë të shkujdesur pasuria ndaj dënimit e zemërimit të Allahut e as të na verbojë syrin e zemrës.

3- Që të mos na përfshijë dënimi, duhet hequr dorë nga të këqijat, nga ndyrësitë, nga egoizmi, nga mendjemadhësia dhe nga kokëfortësia.

4- Çdo vend mund të jetë mejdan i dënimit të Allahut, sepse Allahu është Sunduesi i Tokës dhe Pronari i vërtetë i saj.

5- Kur të vijë ndëshkimi i Allahut, askush nuk është në gjendje ta përballojë atë. Askush nuk ikën e askush nuk kthehet në këtë dynja. Në suren “El Mu'minun”, ajetet 107-108 thuhet: **“O Zoti ynë, nxirrna prej Xhehenemit e, nëse kthehemi prapë tek e keqja, atëherë jemi keqbërës të vërtetë”. Ai do t’u thotë: “Rrini aty të përbuzur dhe mos Më flisni asgjë!”**

6- Allahu ka dashur që njeriu të jetë i lirë dhe të besojë bazuar në të menduarit e në meditim rreth të vërtetave të krijimit dhe jo të besojë me dhunë e imponim. Në ajetin 3 të sures “Insan”, Allahu thotë: **“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës”.**

Kurse në ajetin 29 të sures “El Kehf” thuhet: **“Dhe thuaj: ‘E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë’”.**

7- Mosha është në dorë të Allahut, siç thotë ajeti 68: **“Kujtdo, që i japim jetë të gjatë, Ne e bëjmë sërish krijesë të dobët”.**

8- Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që po studiojmë, tregon gjendjen e njeriut në fundin e jetës së tij dhe thekson pafuqinë e tij mendore e trupore. Kjo gjendje, në të vërtetë, është një paralajmërim për njerëzit, që ata të zgjedhin sa më shpejt që të ndjekin udhëzimin për në rrugën e drejtë, njëkohësisht është edhe një përgjigje për ata që përgjegjësinë

për lënien mangët të detyrimeve që kanë, mundohen ta justifikojnë me jetën e tyre të shkurtër.

Gjithashtu, kjo gjendje e njeriut në moshë të thyer është edhe një argument tjetër që vërteton fuqinë e Allahut të Lartësuar, argument që i tregon njeriut se Allahu është i Gjithëfuqishëm të kthejë njeriun e fortë e të fuqishëm në të pafuqishëm, si të ishte një fëmijë i vogël, njëkohësisht e njofton njeriun se Allahu është i Gjithëfuqishëm të ringjallë njeriun pas vdekjes, ashtu siç është i Gjithëfuqishëm të mbyllë sytë e mohuesve dhe t'u heqë atyre mundësinë për të lëvizur. Të gjitha këto gjendje të mundshme për njeriun, shpjegohen qartë në fjalët e ajetit të nderuar: **"Atë që Ne e lëmë të jetojë gjatë, e kthejmë prapa në krijimin e tij; a nuk po mendojnë?"**.

Në ajetin 5 të sures "El Haxh", Kur'ani famëlartë e thekson këtë kuptim: **"...dhe prej jush ka që jetojnë deri në pleqëri të thellë, aq sa nuk i mbetet asgjë nga dituria që kishte..."**

9- Kur'ani fton në meditim. Këtë e dëshmon fundi i ajetit 68: **"a nuk po mendojnë"**. Të shumta janë këto fraza në Kur'anin e shenjtë, që e urdhërojnë njeriun të mendojë të arsyetojë e të përsiatë.

Të dashur vëllezër dhe motra!

Këto thënie të Allahut janë një sinjalizues mahnitës për të tërhequr vëmendjen e njeriut, për t'i kujtuar atij plakjen. Ajeti u thotë njerëzve se forca e fuqia që ju keni, është kalimtare dhe ju nuk e kuptoni si ju hiqet kjo fuqi e forcë, prandaj dijeni se fuqia e forca juaj është në dorën e të Gjithëfuqishmit, në dorën e Atij që është i Fuqishëm mbi të gjitha sendet. Prandaj, para se të arrini në këtë fazë të jetës suaj, pastrojeni shpirtin tuaj, para se kjo gjallëri e bukuri të shndërrohet në fishkje e vdekje, mblidhni trëndafilat prej këtij kopshti dhe merrni furnizim në këtë botë për rrugën e gjatë e të largët që do të bëni për në Botën Tjetër, sepse, kur të thinjeni, kur të jeni të sëmurë e të pafuqishëm, nuk do të keni mundësi të bëni asnjë punë me vlerë.

Sa e mrekullueshme është këshilla që Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij) i dha Ebu Dherrit: *"Shfrytëzo rastin prej pesëve para pesëve: rininë tënde para pleqërisë, shëndetin tënd para sëmundjes, pasurinë tënde para varfërisë, kohën tënde të lirë para kohës kur je i zënë me punë dhe jetën tënde para se të të vijë vdekja"*.

AJETET 69 - 70

Në këtë moment do të paraqesim mësimet që përmbajnë ajetet 69 dhe 70 të sures "Jâ Sîn". Në këto dy ajete Allahu i Gjithëditur e i Urtë thotë:

وَمَا عَلَّمْنَاهُ الشِّعْرَ وَمَا يَنْبَغِي لَهُ إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ وَقُرْآنٌ مُبِينٌ لِّیُنذِرَ مَن كَانَ حَيًّا وَيَحِقُّ الْقَوْلُ عَلَى الْكَافِرِينَ

69. Ne as nuk i mësuam atij (Muhamedit) poezinë dhe as ajo nuk i takon atij, porse ai (Kur'an) nuk është gjë tjetër veçse këshillë dhe Kur'an i qartë.

70. Për të paralajmëruar atë që është i gjallë (me mendje e me zemër) dhe që dënimi të bëhet i meritueshëm për mohuesit.

Në ajetin 44 të sures "En Neml", Allahu i Madhëruar thotë:

بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

(Të dërguarit i çuam) **me prova të qarta dhe libra. Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kur'anin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë".**

Qëllimi dhe synimi i Kur'anit famëlartë, i kësaj mrekullie të përjetshme për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*), që përmban

këshillat dhe udhëzimet e Krijuesit, është të ringjallë zemrat e njerëzve dhe t'i mbushë ato me shpresë, me besim, me njohuri, dije dhe me dritën e Allahut.

Kur politeistët mekas panë se mesazhi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*) ishte në kundërshtim me besimin dhe me interesat e tyre, ata e akuzuan Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*) se ishte poet. Gjithashtu, e akuzuan se ishte i çmendur, magjistar, thashethemexhi, prift etj...

Nga këto ajete mësojmë:

1- Kur'ani nuk thotë se poezia është e ndaluar. Ai thotë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*) nuk është poet, por është i Dërguari i Allahut, të cilit iu zbrit Kur'ani. Edhe Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*) ka pasur poet, i cili ishte Hasan ibn Thabit. Faza e ajetit: **“Ne as nuk i mësuam atij (Muhamedit) poezinë”**, është në kuptimin se ai është larg poezisë dhe të gjitha udhëzimet, mësimet, atij i zbresin prej Allahut të Lartësuar. Profetët i ndjekin ata që dëshirojnë udhëzim, ndërsa poetët i ndjekin të humburit, siç thuhet në suren “Esh Shuara”, nga ajeti 224-227: **“Poetëve u shkojnë prapa të humburit. A nuk e sheh se ata (poetët) hidhen nga njëra (degë) në tjetrën (thurin lavde, ose ironizojnë). Në të vërtetë, ata (poetët) thonë atë çka nuk e**

bëjnë. Përveç atyre (poetëve) që besojnë, bëjnë vepra të mira, e përmendin shumë Allahun dhe mbrohen".

2- Allahu është mbrojtësi i profetëve të Tij nga çdo lloje akuze që u bëhet atyre.

3- Mospasja dije për poezinë nuk përbën problem dhe pengesë për predikuesin e fesë së Allahut.

4- Ashtu si shumë dhunti të ndryshme, edhe dhuntia e poezisë është nga Allahu. Këtë e dëshmon edhe ajeti 78 i sures "En Nisa": **"Thuaju: Të gjitha janë prej Allahut".**

5- Edhe në Kur'an gjenden ajete me rimë, mirëpo ai nuk është libër poezish, sepse burimi i poezive është fantazia, iluzioni, kurse burimi i Kur'anit është Allahu i Plotfuqishëm, i Gjithëdijshtëm e i Urtë.

6- Mësuesi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*) është Allahu, siç thuhet në ajetin 4 të sures "Er Rrahman": **"i ka mësuar atij të folurit e qartë"** dhe në ajetin 5 të sures "En Nexhm": **"Atë ia ka mësuar atij një (engjëll) shumë i fuqishëm (Xhebraili)".**

7- Disa njohuri nuk janë të përshtatshme për disa njerëz, ashtu siç nuk ishte e përshtatshme poezia për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*).

8- Kur'an i është dhikër (kujtesë), siç thotë ajeti 69 i sures "Jâ Sîn": **"porse ai (Kur'an) nuk është gjë tjetër veçse këshillë dhe Kur'an i qartë"**.

Është kujtesë për fuqinë e Allahut, për mirësitë dhe begatitë e Allahut, për faljen dhe mëshirën e Allahut, kujtesë për dispozitat dhe ligjet e Allahut, kujtesë për vdekjen, për krijimin e gjithësisë me gjithçka që ndodhet në të.

9- Kur'an i është fjalë e qartë dhe e kuptueshme. Është në përputhje të plotë me natyrën e njeriut. Qëllimi me zbritjen e Kur'anit është që me atë të plotësohet argumenti i paralajmërimit, siç thotë ajeti 70 prej ajeteve që po flasim: **"Për të paralajmëruar atë që është i gjallë (me mendje e me zemër) dhe që dënimi të bëhet i meritueshëm për mohuesit"**.

Në lidhje me thirrjen e Kur'anit, njerëzit, ndahen në dy kategori:

E para është *kategoria e të gjallëve*, të ndërgjegjshëm, që i përgjigjen thirrjes së Kur'anit dhe u kushtojnë vëmendje paralajmërimeve që bën ai;

E dyta është *kategoria e mohuesve*, zemra e të cilëve është e vdekur, prandaj prej tyre kurrë nuk shpresohet se ata mund t'i përgjigjen thirrjes së Kur'anit. Në të vërtetë, këto paralajmërimë janë shkak që për mohuesit të plotësohen argumentet dhe dënimi për ata bëhet plotësisht i meritueshëm.

10- Paralajmërimet e Kur'anit janë zgjim për njerëzit nga gjumi i shkujdesjes.

11- Shenjë e jetës së zemrës është kur ajo pranon paralajmërimet e Kur'anit.

12- Udhëzimi i Kur'anit nuk është i posaçëm për një popull apo për një grup njerëzish. Ai është për çdo njeri të gjallë, siç thotë ajeti 70: **"Për të paralajmëruar atë që është i gjallë"**.

13- Qëllimi i zbritjes së Kur'anit dhe i dërgimit të profetëve është zgjimi i zemrave, rigjallërimi i tyre dhe plotësimi i argumentit për mosbesimtarët me zemra të vdekura.

14- Te zemërgurët nuk ndikon as këshilla, as paralajmërimi, madje as fjalët e Allahut.

15- Jobsimtarët që nuk ia vënë veshin të drejtës, të vërtetës, ata janë të vdekur që ecin mbi tokë.

16- Premtimi i dënimit të jobsimtarëve është i patjetërsueshëm. Këtë e dëshmon fundi i ajetit 70: **"dhe që dënimi të bëhet i meritueshëm për mohuesit"**.

Në mbyllje, i lutem Allahut, ashtu siç thuhet në ajetin 23 të sures "El A'raf":

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

"Zoti ynë! Ne i kemi bërë padrejtësi veteve tona. Nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, do të jemi prej të humburve".

AJETET 71 - 76

Në ajetet 71-76 Allahu i Madhëruar thotë:

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّا خَلَقْنَا لَهُمْ مِنَّا عَمَلَتْ أَيْدِينَا أَنْعَامًا فَهُمْ لَهَا مَالِكُونَ وَذَلَّلْنَاهَا لَهُمْ فَمِنْهَا رَكُوبُهُمْ وَمِنْهَا يَأْكُلُونَ وَلَهُمْ فِيهَا مَنَافِعُ وَمَشَارِبُ أَفَلَا يَشْكُرُونَ وَاتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ آلِهَةً لَّهُمْ يُنصِرُونَ لَا يَسْعَئِطِغُونَ نَصْرَهُمْ وَهُمْ لَهُمْ جُنْدٌ مُّخَصَّرُونَ فَلَا يَنْزِلُكَ قَوْلُهُمْ إِنَّا نَعْلَمُ مَا يُسِرُّونَ وَمَا يُغْلِظُونَ

71- A nuk e shohin se për ata Ne me fuqinë Tonë krijuam kafshë që ata i kanë në pronësi?

72- Ne i bëmë ato (kafshët) të nënshtuara ndaj tyre, disa ata i përdorin për hipje dhe prej disa të tjerave ushqehen.

73- Prej kafshëve ata kanë edhe dobi të tjera e pije (qumësht); a nuk duhet të falënderojnë?

74- Por, ata në vend të Allahut adhurojnë zota të tjerë, me shpresë se do të ndihmohen prej tyre.

75- Ata (zotat e rremë) nuk mund t'i ndihmojnë ata, megjithëkëtë, ata (idhujtarët) janë bërë ushtri e gatshme për ata (idhujt).

76- Ti mos u brengos për fjalët që ata thonë, Ne dimë çka ata e mbajnë të fshehtë dhe atë çka ata e bëjnë sheshit.

Para se të themi se çfarë mësojmë nga këto ajete, le të hedhim një sy në disa ajete të tjera të Kur'anit famëlartë, që trajtojnë çështjen e adhurimit, se kush duhet të adhurohet.

Në ajetin 157 të sures "El A'raf", Allahu i Madhëruar thotë:

"...قَالَيْنِ آمَنُوا بِهِ وَعَزَّرُوهُ وَنَصَرُوهُ وَاتَّبَعُوا النُّورَ الَّذِي أُنْزِلَ مَعَهُ ۖ أُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ"

"...ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit".

Kur'ani është dritë. Ai ndriçon zemrën dhe shpirtin. Nëse shoqërohem me Kur'anin, do të shohim se si do të ndriçohet zemra dhe shpirti ynë. Me bekimin e Kur'anit, shumë errësira dhe perde largohen nga zemra dhe shpirti i njeriut. Me mirësitë e Kur'anit, njeriu del nga errësitat e iluzioneve, gabimeve, rrëshqitjeve dhe dyshimeve, duke ecur në dritën e udhëzimit. Rruga e shpëtimit për të gjithë popujt myslimanë, është afrimi me Islamin dhe me Kur'anin. Nëse një komb është në gjendje të jetojë me atmosferën kur'anore dhe të fitojë prej dijes kur'anore, do të jetë në gjendje të kapërcejë problemet që i dalin. Problemi më i madh nga i cili vuajnë myslimanët, është largimi nga Kur'ani. Ilaçi i problemit është kthimi te Kur'ani.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Njeriu ka mundësi që të arrijë ta njohë Krijuesin e tij nëpërmjet të shikuarit dhe të menduarit në krijimin e krijesave që ai i shikon çdo ditë dhe një prej atyre krijesave janë edhe kafshët. Sa bukur e thotë ajeti: ***“A nuk e shohin se për ata Ne me fuqinë Tonë krijuam kafshë që ata i kanë në pronësi?”*** Të gjitha kafshët, si: lopët, delet, kuajt, devetë etj, Allahu i krijoi për njeriun, që të përfitojë prej tyre, qoftë për ngrënie, qoftë për transport.

2- Njeriu ka rol në prodhim, por jo në krijim, sepse Krijuesi është Allahu i Plotfuqishëm, që është Një i Vetëm e i Pashoq.

3- Allahu është Krijuesi, Dhënësi, Furnizuesi. Çdo gjë që në kemi, është nga Allahu i Plotfuqishëm.

4- Mirësitë e Allahut për njerëzit janë të panumërta, siç thuhet në ajetin 18 të sures “En Nahl”: ***“Nëse do t’i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t’i llogarisnit ato”***. Njerëzit janë të pavëmendshëm ndaj mirësive të Allahut dhe shumica e tyre janë mosmirënjohës ndaj Krijuesit.

5- Nga dielli, uji, bimët përfitojnë edhe krijesat e tjera, por nga kafshët përfitojnë më shumë njerëzit.

6- Prej parimeve të fesë islame është të qenit e njeriut pronar në këtë jetë, edhe pse njeriu nuk ka rol e ndikim në

krijim. Mirëpo njeriu është pronar relativ, sepse Pronari i vërtetë dhe absolut është vetëm Allahu. Pra, të qenit e njeriut pronar, është prej parimeve të fesë islame.

7- Nëse lopët, delet, dhitë e devetë do të ishin prej kafshëve të egra, njeriu nuk do të përfitonte nga qumështi i tyre dhe nënproduktet e tij dhe as për udhëtim. Por Allahu i Madhëruar, me fuqinë e mirësinë e Tij, i nënshtroi këto kafshë për njeriun, siç thotë ajeti 72 prej ajeteve në fjalë: **“Ne i bëmë ato (kafshët) të nënshtroara ndaj tyre, disa ata i përdorin për hipje dhe prej disa të tjerave ushqehen”**.

8- Gjithçka në këtë jetë Allahu e ka nënshtroar dhe e ka vënë në shërbim të njeriut, Tokën, ujin, kafshët, qiellin, diellin, yjet, ajrin etj, mirëpo njeriu është arrogant ndaj mirësive të Allahut.

9- Çdo gjë, Allahu e ka krijuar me qëllim dhe nuk e ka krijuar kot, mirëpo ne nuk arrijmë ta kuptojmë qëllimin e tyre, ashtu siç thuhet në ajetin 85 të sures “Isra”: **“...ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni”**.

10- Bulmeti (qumështi, kosi, djathi, gjiza, gjalpi) janë mirësi e veçantë e Allahut për njerëzit. Prandaj Allahu duhet falënderuar për këtë mirësi, siç thotë ajeti 73 prej ajeteve në fjalë: **“Prej kafshëve ata kanë edhe dobi të tjera e pije (qumësht); a nuk duhet të falënderojnë?”** Sigurisht që falënderimi duhet të burojë nga njohja e Dhënësit, Allahut Fuqiplotë dhe nga besimi. A e keni menduar ndonjëherë pyetjen: Në cilin vit “është ndërtuar” fabrika e prodhimit të

qumështit të lopa, delja, deveja, dhia? Si u gjet ajo te këto kafshë?

11- Prej përfitimeve të tjera nga kafshët është prodhimi i veshjeve prej leshit të tyre. Prodhimi i qilimave dhe i tapeteve. Prodhimi i këpucëve nga lëkura e tyre. Një tjetër përfitim nga kafshët është edhe plehu i tyre, të cilin e përdorin bujqit për plehërimin e tokave, pemëve dhe të mbjellave të ndryshme. A nuk e meriton Krijuesi i këtyre kafshëve, me dobi të shumta për njeriun, që të falënderohet?. I lartësuar është Krijuesi!

12- Idhujtaria dhe adhurimi i idhujve është padrejtësi e madhe ndaj Krijuesit dhe mohim për mirësitë e Tij.

13- Shkak i idhujtarisë janë fantazitë dhe hamendësimet e kota. Intelekti dhe natyra e pastër e njeriut e çojnë njeriun në besimin e vërtetë e të pastër, që është besimi në Allahu e Plotfuqishëm.

14- Ndhimja vjen nga Allahu. Gabon ai që mendon, ose shpreson, se do të ndihmohet nga të tjerë përveç Allahut. Ajeti 74 i ajeteve në fjalë, thotë: **“Por, ata në vend të Allahut adhurojnë zota të tjerë, me shpresë se do të ndihmohen prej tyre”**. Zotat e rremë, sado të shumtë të jenë, nuk ndihmojnë për asgjë. Këtë e dëshmon ajeti 75 i ajeteve në fjalë: **“Ata (zotat e rremë) nuk mund t’i ndihmojnë ata, megjithëkëtë, ata (idhujtarët) janë bërë ushtri e gatshme për ata (idhujt)”**.

15- Ndëshkimi i atij që mohon mirësitë e Allahut dhe i atij që i shoqëron ortak Atij, është Zjarri i Xhehenemit.

16- Ai që ka marrë mbi supe një qëllim të madh, është më në shenjë për t'u goditur nga shigjetat e dashakeqësve, siç ndodhi me profetët dhe me Profetin tonë të dashur. Por Allahu ka qenë ndihmësi, ngushëlluesi i tyre në çdo moment. Në ajetin 76 të ajeteve në fjalë, thuhet: **"Ti mos u brengos për fjalët që ata thonë, Ne dimë çka ata e mbajnë të fshehtë dhe atë çka ata e bëjnë sheshit".**

Këto ishin disa nga mësimet e këtyre ajeteve të begata të sures "Jâ Sîn" . Në ajetin 9 të sures "Isra" Allahu thotë: **"Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh".**

E lus Allahun, që të na bëjë prej përfituesve nga Kur'ani i shenjtë! Allahu na e ndriçoftë zemrën dhe jetën me dritën e Kur'anit! Allahu na dhuroftë shefatin e Kur'anit në Jetën Tjetër!

AJETET 77 - 80

Në ajetet 77-80 të sures “Jâ Sîn” , thuhet:

أَوَلَمْ يَرِ الْإِنْسَانُ أَنَّا خَلَقْنَاهُ مِنْ نُطْقَةٍ فَإِذَا هُوَ خَصِيمٌ مُبِينٌ وَضَرَبَ لَنَا مَثَلًا وَنَسِيَ خَلْقَهُ قَالَ مَنْ يُحْيِي الْعِظَامَ وَهِيَ رَمِيمٌ قُلْ يُحْيِيهَا الَّذِي أَنشَأَهَا أَوَّلَ مَرَّةٍ وَهُوَ بِكُلِّ خَلْقٍ عَلِيمٌ الَّذِي جَعَلَ لَكُم مِّنَ الشَّجَرِ الْأَخْضَرِ نَارًا فَإِذَا أَنتُم مِّنْهُ تُوقَدُونَ

77- A nuk e shikon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pike spermatozoidi, porse ai bëhet kundërshtar i rreptë?

78- Sjell shembuj për Ne, harron krijimin e vet dhe thotë: kush i ringjall kockat e bëra pluhur?

79- Thuaj, ato i ringjall Ai që i krijoi ato herën e parë; Ai ka dijeni të plotë për çdo krijim.

80- Ai që prej drurit të gjelbër për ju bëri zjarrin dhe prej tij ju ndizni.

Para se të themi se çfarë mësojmë nga këto ajete, le të hedhim një sy në disa ajete të tjera të Kur'anit famëlartë, që trajtojnë çështjen e jetës së shëndetshme për ata njerëz që jetojnë me Kur'anin, që e mësojnë përmendësh atë.

Në ajetin 29 të sures "Saad", Allahu i Gjithëditur thotë:

كِتَابُ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ

"Ky (Kur'an) është një Libër i Bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t'u këshilluar me të poseduesit e mendjes".

Momentet më të lumtura të jetës sonë janë kur jetojmë me Librin e Krijuesit, Kur'anin e shenjtë, duke medituar në argumentet dhe kuptimet e tij. Kulmi i lumturisë është kur për herë të parë shohim të vërteta të reja në Kur'an, të cilat i dëshmon edhe shkenca. Sa e bukur është për një besimtar, kur çdo moment të jetës së tij e jeton me Kur'anin. Sa bukur është të takosh Allahun në Jetën Tjetër, ndërkohë që ke mbartur dhe ke zbatuar Fjalën e Tij në këtë jetë!

Një njeri punëmirë, kur ishte në shtratin e vdekjes, e thirri djalin e vet dhe i tha: - Biri im! Më jep Kur'anin, sepse kam harruar një ajet nga Kur'ani dhe do të doja ta rikujtoja atë.

- O babai im! - i tha djali. - Çfarë dobie do të të sjellë rikujtimi i ajetit, në këto momente?

- Për mua është më e dashur ta takoj Allahun dhe ta kem mësuar këtë ajet, sesa ta takoj Atë dhe ta kem harruar këtë ajet! - i tha njeriu punëmirë.

Prej këtu, të dashur vëllezër dhe motra, e kuptojmë rëndësinë e takimit me Allahun, ndërkohë që i kemi mësaure përmendësh fjalët e Tij. Por a ka dobi të kësaj bote për atë që i mëson përmendësh fjalët e Zotit të Madhëruar në gjoks? Sigurisht që ka. Disa studime të reja shkencore kanë vërtetuar ndikimin e mahnitshëm në shëndetin psikologjik dhe fizik të atyre që e mësojnë përmendësh Kur'anin. Studimet thonë se sa më i lartë të jetë niveli i mësimi përmendësh të Kur'anit të shenjtë, aq më i lartë është niveli i shëndetit psikologjik të hafizi të Kur'anit. Çfarë mrekullie! Jo më kot Allahu na thotë se Kur'ani është shëruar për ato që gjenden në krahë.

Për shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve, në librat e tefsirit citohet një transmetim i ardhur nga imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Te Profeti shkoi në politeist. Thuhet se ishte Ubej ibn Khalef, ose El As ibn Vail. Ai mbante në dorë një kockë të kalbur, që e kishte marrë prej një muri dhe pasi e thërrmoi kockën me dorë, tha: ‘Kur ne të jemi kocka të bëra pluhur, qysh do të ringjallemi përsëri?!’ Për t’iu përgjigjur atij politeisti, Allahu i zbriti Profetit Muhamed ajetin: **“Thuaj, ato i ringjall Ai që i krijoi ato herën e parë; Ai ka dijeni të plotë për çdo krijim”**.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Fillimi i jetës së njeriut është nga një spermatozoid, i cili është i përgatitur dhe i përshtatur për fillimin e një jete njerëzore. Ky ajet, ashtu si dhe shumë ajete të tjera, hedh poshtë teorinë se njeriu e ka prejardhjen nga majmuni, por njeriu është krijuar nga Allahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm. Kur'ani i shenjtë shpjegon formimin e njeriut në barkun e nënës dhe thotë se ky formim kalon nëpër gjashtë etapa, të cilat në Kur'anin famëlartë emërtohen si vijon: spermatozoidi (en nutfeh), masa e ngjitur (el alekah), gjaku i mpiksuar (el mudgah), kockat, veshja e kockave me mish dhe formimi i plotë. Pas lindjes, njeriu është i pafuqishëm dhe s'ka fuqi për asgjë; më pas vijnë etapat e rritjes së tij të shpejtë, deri sa arrin moshën e formimit të plotë trupor e mendor.

Ajeti 77 i bën thirrje njeriut të mendojë thellë: **"A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pike spermatozoidi, porse ai bëhet kundërshtar i rreptë?"**

2- Nëse njeriu e mendon dobësinë dhe paaftësinë e tij dhe ai gjithmonë ka nevojë për Krijuesin e tij, kurrë nuk do ishte kundërshtar, por do të ishte besimtar dhe mirënjohës ndaj Krijuesit të tij. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Njeriu është armik (kundërshtues) i asaj që nuk njeh".

3- Të kujtuarit e krijimit të tij nga një pikë sperme, ia forcon njeriut besimin në Ringjallje.

4- Kundërshtimi i Allahut, nga ana e njeriut, është një çështje shumë e habitshme dhe nuk duhet të ndodhë, sepse ky njeri mendjemadh, sikur të mendojë fare pak, do të mësojë se fillimi i tij është prej një uji të ndenjtur me erë të keqe. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Pse duhet të krenohet njeriu? Ka nisur si pikë sperme dhe do përfundojë si kufomë. Vetën s’e mban dot, as takimin me vdekjen s’e shmang dot”.

5- Mendimet devijuese dhe shtesat e reja të dëmshme duhen sqaruar me argumente logjike, me argumente nga Kur’ani, nga hadithet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij*) dhe të imamëve të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta*).

6- Shumica e keqkuptimeve të njerëzisë, në lidhje me fuqinë e Allahut, buron ngaqë ata janë të pavëmendshëm ndaj krijimit të krijesave. Ata nuk mendojnë në krijimin e krijesave që i rrethojnë dhe që i shikojnë ato në çdo çast.

7- Mohuesit e Ringjalljes nuk kanë asnjë argument në mohimin e tyre. Nëse do të përdornin pak logjikën e tyre, do të ishin besimtarë, sepse argumentet e Ringjalljes janë shumë të qarta. Një prej argumenteve të Ringjalljes është ardhja e pranverës, të cilën njerëzisë e përjetojnë çdo vit në jetën e tyre.

8- Nuk gjendet problem, kur dikush pyet për të kuptuar. Por është e shëmtuar kur pyetja bëhet për provokim, për t’u shtirur e dukur sikur je i ditur apo kur

pyetja bëhet për ta nënvlerësuar dikë dhe për ta ulur në sy të tjerëve. (Kur dikush i kërkoi Imam Aliut të gjente se sa fije të bardha floku kishte në kokë).

9- Fuqia e njeriut kurrë nuk është si ajo e Krijuesit.

10- Ringjallja do të jetë me trup dhe me shpirt. Këtë e dëshmojnë ajetet 78 dhe 79: **"...kush i ringjall kockat e bëra pluhur? Thuaj, ato i ringjall Ai që i krijoi ato herën e parë; Ai ka dijeni të plotë për çdo krijim"**.

11- Që të realizohet Ringjallja duhen me patjetër dy gjëra: Fuqia dhe dija për punët e njeriut në këtë jetë. Ajeti 79 na mëson se Allahu është pronari i fuqisë dhe i diturisë. Ajeti thotë: **"Ai që i krijoi ato herën e parë"**. Ky ajet sqaron fuqinë absolute të Krijuesit. Dhe: **"Ai ka dijeni të plotë për çdo krijim"**. Pra, Allahu është i Gjithëditur dhe i Mirinformuar për veprat e njeriut në këtë jetë.

12- Njeriu është një krijesë mendjemadhe dhe harron shumë. Veç kësaj, njeriu, në polemikat e tij, të gjitha mirësitë që Zotëruesi i mirësive i ka vënë në dispozicion të tij, i përdor kundër Krijuesit dhe e shpall hapur armiqësinë e tij kundër Allahut të Lartësuar. Shiko sa i shkujdesur e sa mendjelehtë është njeriu! Për të mësuar se deri ku shkon shkujdesja, mendjelehtësia e njeriut, ajeti vijues shpjegon: **"Sjell shembuj për Ne, harron krijimin e vet dhe thotë: 'Kush i ringjall kockat e bëra pluhur?'"**

13- Allahu i Plotfuqishëm është Ai që bashkon dy të kundërtat, të cilat për njeriun është diçka e pamundur për t'i realizuar. Allahu i Lartësuar, në ajetin 80: **“Ai që prej drurit të gjelbër për ju bëri zjarrin dhe prej tij ju ndizni”**, shpjegon se Ai që ka fuqi të bëjë që prej drurit të gjelbër të ndizet zjarr, patjetër që ka fuqi t'i riveshë të vdekurit me rrobën e jetës.

Uji dhe zjarri janë dy gjëra të kundërta, por Ai që ka mundësi t' bashkojë këto të dyja në të njëjtin vend, patjetër që ka mundësi të bëjë së bashku, në të njëjtin vend edhe jetën e vdekjen. Ai që krijon zjarrin në mesin e ujit dhe ujin në mesin e zjarrit, pa diskutim ka fuqi të ngjallë trupin e njeriut të vdekur, pa asnjë problem e pa asnjë vështirësi. I lartësuar është Krijuesi Fuqiplotë!

O njeri që harron kaq shumë! Ktheje kokën prapa dhe shiko në krijimin tënd. Mendo se ishe një pikë ujë pa asnjë vlerë dhe se çdo ditë merrje një formë të re gjatë etapave të jetës. Ti o njeri, je në një gjendje vdekjeje dhe ringjalljeje të vazhdueshme. Por të gjitha këto ti i harron dhe fillon të pyesësh: Kush do t'i ringjallë kockat e kalbura, të bëra pluhur? A nuk ishe ti, o njeri, në fillim baltë, ashtu siç janë këto kocka të kalbura?! Zgjohu o njeri nga gjumi i shkujdesjes! Hiqe perden e mendjemadhësisë, të vetëpëlqimit e të kryeneçësisë! Kthehu te Krijuesi i gjithësisë, i cili na thotë:

وَقُلْ أَعْمَلُوا فَسَيَرَى اللَّهُ عَمَلَكُمْ وَرَسُولُهُ وَالْمُؤْمِنُونَ وَسَتُرَدُّونَ إِلَىٰ عِلْمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَيُنَبِّئُكُم بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ

“Thuaj: ‘Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t’ju njoftojë për atë që keni bërë’”.

AJETET 81 - 83

Në tri ajetet e fundit të sures “Jâ Sîn”, thuhet:

أَوَلَيْسَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ بِقَادِرٍ عَلَى أَنْ يَخْلُقَ مِثْلَهُمْ بَلَىٰ وَهُوَ الْخَلَّاقُ الْعَلِيمُ إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ فَسُبْحَانَ الَّذِي يَبْدِئُ مَلَكُوتَ كُلِّ شَيْءٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

81. Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, a nuk ka fuqi të krijojë të ngjashëm me ata? Po, Ai është Krijuesi, i Dituri.

82. Kur Ai dëshiron një send, urdhri i Tij është: “Bëhu!” dhe ai (sendi) bëhet menjëherë.

83. I lartë është vetëm Ai, në dorën e të Cilit është pushteti mbi çdo send dhe te Ai do të ktheheni.

Allahu i Madhëruar, në ajetin 155 të sures “El En’am”, thotë:

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni”.

Ky ajet dëshmon se Kur’ani është libër i Allahut, i bekuar dhe kushdo që kapet pas Kur’anit, do të bekohet në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër. Kur’ani duhet ndjekur dhe të

mos kundërshtohet. Nëse duam të mëshirohemi, atëherë të ndjekim Kur'anin. Nuk vjen libër tjetër nga Allahu pas Kur'anit. E kemi thënë gjithmonë se Kur'ani është dritë, udhëzim, këshillë, shërim dhe mëshirë. Kushdo që dëshiron të arrijë sa më afër Krijuesit të tij, duhet të ketë Kur'anin prijtës në jetën e vet.

Kur'ani është përsosmëria e vërtetë. Cilido që e mëson Kur'anin dhe e kristalizon atë në qenien e tij, sigurisht që ai mbart një mirësi të madhe dhe pasuri të pashtershme. Kur'ani është sofra e Allahut për njerëzit, të cilën e ka zbukuruar këtë tryezë me llojet më të përsosura e të panumërta të ushqimeve për shpirtin, zemrën dhe për mendjen. Në këtë tryezë gjendet çdo gjë për të cilën kanë nevojë njerëzit. Allahu i Madhëruar thotë: **"Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kuran për çdo gjë, për t'ua vënë veshin".**

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Sigurisht, ky Kur'an është tryeza e Allahut, prandaj, studiojeni sa të mundeni tryezën e Tij".*

Kur'ani është depozita e dijeve të Allahut. Ai që ndriçohet me këtë dije dhe i mbart ato, do të jetë prej banorëve të Xhenetit. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Mbartësit e Kur'anit janë të diturit e banorëve të Xhenetit".*

Në ajetet e mëparshme, 77-81, u përmendën argumentet që vërtetojnë Ringjalljen, u tërhoq vëmendja

rreth zanafillës së krijimit të parë dhe daljes së zjarrit prej drurit të gjelbër. Në këto tri ajete, të cilat janë ajetet e fundit të sures “Jâ Sîn”, sqarohet fuqia absolute e Allahut të Lartësuar. Edhe këto ajete të begata përmbajnë mësimet të ndryshme, që janë dritë, udhëzim dhe shpëtim për mbarë njerëzit.

Nga këto ajete mësojmë:

1- Pyetja është prej mjeteve të zgjimit të ndërgjegjes. Në ajetin 81 Allahu i Lartësuar na pyet: **“Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, a nuk ka fuqi të krijojë të ngjashëm me ata?”** Pra, o njerëz! A nuk e shihni hapësirën e pamatur të qiellit, diellin, hënën, yjet që lëvizin në hapësirat e qiellit me shumë saktësi e rregull? Patjetër, Ai që ka fuqi të krijojë të gjitha botët, që s’kanë anë e fund dhe për të cilat ka vënë ligje e sisteme të hollësishme, si nuk paska fuqi të ringjallë të vdekurit? Në të vërtetë, kjo mënyrë paraqitjeje është një argument për dyshuesit dhe mohuesit. Nëse ju dyshoni në fuqinë e Allahut, për të krijuar apo për të ringjallur, dini se vetëm Ai është Krijuesi. Këtu fjala “*Krijuesi*” ka ardhur si mbiemër në shkallën sipërore, domethënë se nuk mund të ketë krijues tjetër përveç Allahut.

2- Mësojmë mënyrën e diskutimit me të tjerët. Në diskutimet me jobesimtarët biseda të ilustruara me shembuj, siç lexojmë në Kur’an i cili në fillim përmendi si shembull spermatozoidin, pastaj drurin e njomë (të përmendura në

ajetet e mëparshme, 77-81), e në fund krijimin e qiejve dhe të Tokës, që i përmend në ajetet në fjalë. Sa bukur na thotë Kur'ani në ajetin 53 të sures "El Fusilet": **"Ne do t'u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se Ai është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?"**

3- Ai që është i aftë dhe i plotfuqishëm të krijojë qiejt dhe tokën, me gjithçka që gjenden në to, Ai është i aftë të krijojë edhe njeriun. Krijimi i qiejve, pa anë e pa fund, si dhe krijimi i tokës ku jetojmë, për fuqinë e Allahut është prej punëve të thjeshta dhe të lehta. Si krijimi i një krijese të madhe, ashtu edhe krijimi i një krijese të vogël, janë të njëjta për Allahun.

4- S'ka ndarje në kohë në mes vullnetit të Allahut dhe gjetjes së një sendi. Urdhri i Tij dhe fjala e Tij "*kun*" – "*bëhu*" përmbushen sa hap e mbyll sytë, siç thuhet në ajetin 50 të sures "Kamer":

وَمَا أَمْرُنَا إِلَّا وَجِدَةٌ كَلَمْحٍ بِالْبَصَرِ

"Ne urdhërojmë vetëm një herë dhe vullneti Ynë përmbushet sa çel e mbyll sytë".

Sa bukur e ka shprehur Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), këtë të vërtetë, në njërën prej hytbeve të tij, në librin "Nehxhul Belaga": "*Kur shfaq vullnetin e Tij, që një send të ekzistojë, Ai thotë "bëhu", pa zë me*

tingull, pa thirrje që dëgjohej; “bëhu” është fjalë e të Gjithëfuqishmit, është punë e dalë prej Tij, kur Ai krijon sendin; një shembull i këtillë nuk mund të gjendet në asnjë qenie...”

5- Te Allahu, krijimi dhe rikrijimi është i njëjtë, siç thuhet në ajetin 28 të sures “Lukman”:

مَا خَلَقْنَا وَلَا بَعَثْنَا إِلَّا نَفْسًا وَاحِدَةً إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ

“Krijimi dhe ringjallja e juaj është njësoj si krijimi i një njeriu të vetëm. Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha”.

6- Sunduesi absolut i gjithësisë është Allahu. Ai është i dëlirë e i pastër nga mangësitë e pamundësitë në fuqinë e Tij. Në këtë këndvështrim, ngjallja e të vdekurve dhe veshja e rrobës së jetës mbi kockat e kalbura e të bëra pluhur, edhe një herë tjetër, për Allahun e Lartësuar, nuk përbëjnë asnjë problem, prandaj dijeni mirë se ju të gjithë do të ktheheni te Ai. Gjithashtu, dijeni mirë se çështja e Ringjalljes është plotësisht e vërtetë. Sa bukur na e sqaron këtë çështje Kur’ani i shenjtë në ajetet 5-7 të sures “Haxhxh”: **“O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë, për t’ju bërë të qartë! Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar. Pastaj ju nxjerrim si fëmijë e pas kësaj do të arrini moshën e pjekurisë. Disa nga ju vdesin e disa ngelin deri në pleqëri të thellë, që të mos dinë asgjë nga ajo që kanë ditur**

më parë. Dhe ti e sheh tokën të tharë, por, kur Ne lëshojmë ujë mbi të, ajo trazohet dhe gufon dhe prej saj mbijnë gjithfarë lloj bimësh të mrekullueshme në çift". Kjo ndodh (që ta dini) se Allahu është e Vërteta, se Ai i ringjall të vdekurit, se Ai është i Fuqishëm për çdo gjë, se Ora (e Kiametit) do të vijë, gjë për të cilën s'ka dyshim dhe se Allahu do t'i ringjallë ata që janë në varre".

Në fund themi se Krijuesi ynë i Plotfuqishëm është Një i Vetëm dhe i Pashoq. Ai nuk ka lindur askënd, nuk është i lindur nga askush dhe nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd. Në ajetin 91 të sures "El Mu'minun", thuhet:

مَا اتَّخَذَ اللَّهُ مِنْ وَلَدٍ وَمَا كَانَ مَعَهُ مِنْ إِلَهٍ إِذَا أَذْهَبَ كُلُّ إِلَهٍ بِمَا خَلَقَ وَلَعَلَّ بَعْضُهُمْ عَلَى بَعْضٍ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُصِفُونَ

"Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s'ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!"

Gjithashtu, në ajetin 22 të sures "El Enbija", thuhet:

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلَ اللَّهِ فَسَدْنَا ۚ فَسُبْحَانَ اللَّهِ رَبِّ الْعَرْشِ عَمَّا يُصِفُونَ

"Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij!"

PËRMBAJTJA

FJALA E BOTUESIT.....	5
Si ta bëjmë Kur'anin shoqërues në jetën tonë?.....	5
MËSIMET NGA SURJA “JÂ SÎN”	13
MIRËSITË E SURES “JÂ SÎN”	14
AJETET 1 – 4.....	16
Nga këto ajete mësojmë:.....	16
AJETET 5 - 9	19
Nga këto ajete mësojmë:.....	21
AJETET 10 – 11.....	25
Nga këto ajete mësojmë:.....	27
AJETI 12.....	30
Nga ky ajet mësojmë:.....	31
AJETET 13 - 17.....	35
Nga këto ajete mësojmë:.....	36
AJETET 18 - 19.....	40
Nga këto dy ajete mësojmë:.....	41
AJETET 20 - 21.....	44
Nga këto ajete mësojmë:.....	45
AJETET 22-27.....	48
Nga këto ajete mësojmë:	49
AJETET 28 - 32.....	54
Nga këto ajete mësojmë:	55
AJETET 33- 36.....	59

Nga këto ajete mësojmë:	60
AJETET 37 - 40.....	64
Nga këto ajete mësojmë:.....	65
AJETET 41 - 44.....	69
Nga këto ajete mësojmë:.....	70
AJETET 45 - 47.....	73
Nga këto ajete mësojmë:.....	74
AJETET 48 - 50.....	78
Nga këto ajete mësojmë:	80
AJETET 51 - 54.....	83
Nga këto ajete mësojmë:.....	84
AJETET 55 - 58.....	88
Nga këto ajete mësojmë.....	89
AJETET 59 - 64.....	93
Nga këto ajete mësojmë:.....	95
AJETI 65.....	98
Nga ky ajet mësojmë:.....	99
AJETET 66 - 68.....	103
Nga këto ajete mësojmë:	105
AJETET 69 - 70.....	109
Nga këto ajete mësojmë:.....	110
AJETET 71 - 76.....	114
Nga këto ajete mësojmë:	116
AJETET 77 - 80.....	120
Nga këto ajete mësojmë:.....	123
AJETET 81 - 83.....	128
Nga këto ajete mësojmë:.....	130



الدروس من سورة يس

الاعداد: الحاج الشيخ ولنت مريا

اسم الكتاب: الدروس من سورة يس

الاعداد: الحاج الشيخ ولنت مريا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

التصحيح الأدبي: اسراء مريا

الايخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم

تيرانا 2024